

KOMUNA E STUDENIÇANIT



STRATEGJI PËR ZHVILLIMIN E TURIZMIT NË KOMUNËN E STUDENIÇANIT 2020-2024

Dhjetor 2020

PËRGADITËN

Ekip pune nga TURISTIKA Shkup: Dejan Metodijeski, Oliver Filiposki, Nako Tashkov, Julijana Sazdova, Goran Antonievski, Çedomir Dimovski, Emilija Todoroviç, Milena Taleska, Kristijan Xhambazovski dhe Nikolla Cuculeski.

Pjesëmarrësit në punëtorinë për përgatitjen e një strategjie për zhvillimin e turizmit në komunën e Studeniçanit: Burhanedin Nuhiu, Fuad Azizi, Orhan Shabani, Nazmi Kadriu, Isnije Iseni, Iljaz Muhaxheri, Adnan Imeri, Fuat Elez dhe Riza Jaja.

Dizajni: Turistika

PARATHËNIE	5
KARAKTERISTIKAT E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT	6
KARAKTERISTIKAT E RAJONIT PLANOR TË SHKUPIT	7
METODOLOGJIA GJATË HARTIMIT TË STRATEGJISË	10
TË DHËNA PËR TURIZMIN	12
TRENDET BASHKËKOHORE NË TURIZËM	16
VIZIONI PËR TURIZMIN NË KOMUNËN E STUDENIÇANIT	18
KARAKTERISTIKAT E KOMUNSË SË STUDENIÇANIT	19
PËRGJATË HISTORISË	19
WEB PORTALI	21
GRUPI I BIZNESIT	21
KARAKTERISTIKAT GJEOGRAFIKE	22
TREGUESIT DEMOGRAFIK	24
VEPRIMTARIA ARSIMORE.....	25
KOMUNAT E VËLLAZËRUARA	25
AKSES	25
VLERAT TURISTIKE	25
VLERAT NATYRORE	26
MALET	26
HIDROGRAFIA	28
VLERAT ANTROPOGJENIKE.....	30
LOKALITETET ARKEOLOGJIKE.....	30
OBJEKTE TË KULTURËS.....	31
OBJEKTE FETARE	32
MANIFESTIME	36
SEKTORI I SHËRBIMEVE	37
HOTELIERIA	37
AKOMODIM	38
AGJENCITË TURISTIKE	38
FABRIKA	38
BANKA.....	38
POSTA	39
ENTE SHËNDETËSORE.....	39
FARMACI.....	39
PIKA KARBURANTI.....	39
TREGJE.....	39
SPORT	39
REKREACION	39

LLOJE TË TURIZMIT	40
PLANI I VEPRIMIT, OBJEKTIVI STRATEGJIK, PRIORITETET DHE MASAT	41
PROCESI IMPLEMENTIMIT TË STRATEGJISË	52
LITERATURA	53

PARATHËNIE



Komuna jonë, Komuna e Studeniçanit, përfshin pjesën jugore dhe jugperëndimore të fushëgropës së Shkupit. Përmban më shumë pamje natyrore dhe antropogjene. Hapësira e komunës ka një strukturë me relief të larmishëm, me shumë mundësi malore dhe hidrografike. Komuna kufizohet me komunat: Sopishtë, Kisella Vodë, Zelenikovq, Çashkë, Makedonski Brod dhe Petrovec.

Përfitimet nga natyra dhe afërsia, si dhe lidhja me komunat fqinje janë një mundësi për zhvillimin e turizmit. Duke e kultivuar misionin e komunës si komunë rurale, me një zonë industriale shumë të zhvilluar, ne përpiqemi që tërësisht t'i shfrytëzojmë burimet natyrore dhe ato ujore. Komuna së bashku me të gjithë aktorët e interesit të zhvillimit ekonomik - qeverisjen lokale, sektorin e biznesit dhe shoqërinë civile, punojnë së bashku dhe kontribuojmë për përparimin e bashkësisë me theks të veçantë në integrimin evropian, në mbrojtjen e natyrës, në përfshirjen sociale dhe barazinë gjinore. Nga arritja e këtij qëllimi, komuna sheh përfitime të mëdha në zhvillimin e turizmit.

Përfitimet e turizmit i vërejmë në zhvillimin e llojeve të ndryshme të turizmit (në turizmin kulturor-historik, turizmin gastronomik, turizmin shëndetësor, aktivitete në natyrë dhe turizëm sportive, si dhe në turizmin e gjuetisë dhe të peshkimit), e me këtë edhe numër të madh të turistëve, si dhe numër të madh të punëtorëve të turizmit dhe hotelierisë.

Me qëllim që të jetë mjedis modern rural ku shumë njerëz do të mund t'a njohin atë si një destinacion për pushim dhe rekreacion, Komuna e Studeniçanit medoemos të ecë drejt procesit të planifikimit dhe procesit të miratimit të dokumenteve strategjike. Përmes kësaj strategjie dhe masave të përshkruara, ne shpresojmë se do t'i përmirësojmë aktivitetet në fushën e turizmit e me këtë t'i zmadhojmë edhe përfitimet e të gjithëve në komunë.

Kryetari i Komunës së Studeniçanit,
Azem Sadiki

KARAKTERISTIKAT E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Republika e Maqedonisë së Veriut është shtet sovran dhe demokratik që shtrihet në pjesën qendrore të Gadishullit Ballkanik. Shumë shekuj më herët, ky territor gjeografik paraqiste lidhje midis botës Lindore dhe asaj Perëndimore, si në aspektin gjeografik, ashtu edhe në atë politik e kulturor. Megjithëse është një vend relativisht i vogël me hapësirë territoriale, vendi përmban natyrë të bukur dhe trashëgimi të pasur kulturore e historike, që janë një nga faktorët themelorë për zhvillimin e turizmit.

Republika e Maqedonisë së Veriut kufizohet me vendet siç vijon: Republikën e Serbisë dhe Republikën e Kosovës në veri, me Bullgarinë në lindje, ndërsa me Greqinë në jug dhe Shqipërinë në perëndim. Kryeqyteti i shtetit është Shkupi me një popullsi prej mbi gjysmë milioni banorë. Qytetet tjera kryesore në vend janë: Manastiri, Kumanova, Prilepi, Tetova, Velesi, Shtipi, Ohri, Gostivari, Strumica, Kërçova, Kavadari dhe Koçani. Secili prej këtyre qyteteve ofron mikpritje specifike për vete dhe një përzgjedhje të pasur atraksionesh që tërheqin vizitorët. Republika e Maqedonisë së Veriut shtrihet në një sipërfaqe prej 25.713 km², ku jetojnë mbi dy milionë banorë.

Republika e Maqedonisë së Veriut është një shoqëri multietnike dhe multikulturore ku praktikohen religjione të ndryshme. Për sa iu përket veçorive të relievit, vendi dominohet nga malet dhe luginat; e gjithashtu gjejmë shumë lumenj, liqene, shpella, gryka, kanjonë etj. Madje 80% i gjithë territorit të vendit është malorë, ndërsa 20% e mbetura përbëjnë tokë të rrafshët. Megjithëse është vend kontinental, Maqedonia e Veriut ka një numër të madh lumenjsh, gjashtëmbëdhjetë male më të larta se 2,000 m. dhe më shumë se 50 liqene, nga të cilat më të rëndësishme për zhvillimin e turizmit janë liqeni i Ohrit, Prespës dhe i Dojranit, ku ekzistojnë plazhe të bukura dhe mjaft atraktive.



Në male ekzistojnë ski-qendra moderne të cilat janë të hapura për vizitorët, si në stinën e dimrit, ashtu edhe në atë të verës. Kushtet klimatike janë të favorshme dhe lejojnë të vizitohen lokalitetet më të rëndësishme gjatë gjithë vitit. Vendi është i pasur me florë dhe faunë të larmishme dhe ka tre parqe nacionale. Ekzistojnë zona me vegjetacion të bukur, me pyje të dendura, me bimë dhe insekte endemike, kafshë të rralla, zogj, zvarranikë, lloje të ndryshme peshqish, etj.

Për të hyrë në Maqedoninë e Veriut ekzistojnë 14 vendkalime kufitare dhe dy aeroporte: në Shkup dhe Ohër. Qytetet në vend janë të ndërlidhura me transport të rregullt të autobusëve përmes një rrjeti të qëndrueshëm rrugor, në më shumë prej tyre funksionon transporti lokal i autobusëve, taksi-kompanitë, si dhe makina që jepen me qira. Rrjeti hekurudhor nuk është aq i pazhvilluar dhe funksionon më ngadalë, ndërsa transporti me anije ekziston nëpër liqene.

Në Maqedoninë e Veriut ekzistojnë një numër i madh i shitoreve si dhe të dyqaneve artizanale në sektorin e shitjes me pakicë, si dhe qendra moderne tregtare, tregje të mbyllura dhe të hapura, ku mund të blihen mallra dhe produkte nga më të ndryshmet. Zonat urbane dhe ato rurale të vendit, kanë një ofertë të pasur të ngjarjeve dhe manifestimeve të ndryshme kulturore, muze, galeri dhe monumente kulturo-historike të cilat mund të vizitohen. Me qëllim të bëhet sa më i këndshëm qëndrimi i vizitorëve, në dispozicion të tyre ekzistojnë mbi 400 agjenci udhëtimi të regjistruara, një numër i madh udhëzuesish të licencuar të udhëtimit në disa gjuhë, si dhe qendra të informacionit turistik në disa qytete.

Zhvillimit të turizmit, si një aktivitet veçanërisht i rëndësishëm në Republikën e Maqedonisë së Veriut, i kushtohet vëmendje e veçantë përmes hartimit të politikave dhe masave për përdorimin sa më efikas të të gjitha potencialeve të turizmit dhe promovimit të tij të suksesshëm.

KARAKTERISTIKAT E RAJONIT PLANOR TË SHKUPIT

Rajoni i Shkupit ndodhet në pjesën veriore të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe mbulon pellgun e fushëgropës së Shkupit. Në një sipërfaqe totale prej 1812km², ekzistojnë 10 komuna të qytetit (Qendër, Karposh, Kisella Vodë, Aerodrom, Gazi Babë, Butel, Çair, Gjorçe Petrov, Saraj dhe Shuto Orizarë) dhe 7 komuna periferike (Sopishtë, Studeniçan, Zelenikovë, Petrovec, Ilinden, Haraçinë dhe Komuna e Çuçer Sandevës). Rajoni karakterizohet me një popullsi dukshëm të dendur prej 319 banorë/ km² ose rreth 578.144 banorë. Numri më i madh i popullsisë, rreth 88% jetojnë në territorin e qytetit të Shkupit.

Rajoni i Shkupit disponon me vlera të konsiderueshme natyrore dhe kulturore - historike dhe ofron mundësi të shkëlqyer për zhvillimin e llojeve të ndryshme të turizmit.


Rajoni i Shkupit kufizohet nga vargjet malore të Malit të Zi të Shkupit në veri, malin Gradishtan në lindje, vargmalet Mokra Gora në jug dhe Karaxhica, Suva Gora dhe Zheden në perëndim. Malet të cilat gjenden afër qytetit të Shkupit dhe të cilat vizitohen nga mijëra vizitorë, janë: Mali i Zi i Shkupit, Zhedeni, Vodno, Kitka, Karaxhica etj. Mali Vodno është mali me lartësi të mesme, më i afërt dhe më i vizituar që gjendet në një pozitë të favorshme gjeografike në afërsi të Shkupit. Maja më e lartë është maja e quajtur Krstovar, me 1066m. e lartë, ku

ekziston një shtëpizë malore dhe një kryq të quajtur Kryqi i Mijëvjeçarit. Në rajonin e Shkupit ekziston edhe një kanion, i quajtur Kanioni i "Matkës" që gjendet në lumin Treska. Në malet përreth dhe buzë fushëgropës ekzistojnë disa shpella, nga të cilat më të njohura janë: Dona Duka, Vrelo, Krshtalna etj.

Rajoni i Shkupit është i njohur gjithashtu me disa lumenj që derdhen në lumin më të madh Vardar. Bëhet fjalë për lumenjtë Treska, Lepenec, Patishka Reka, Kadina Reka dhe disa lumenj tjerë më të vegjël. Lumi Vardar është lumi kryesor dhe ky lum e ndan fushëgropën në dy pjesë - në lindje dhe perëndim. Në afërsi të qytetit të Shkupit ndodhen liqenet artificial: Matka dhe Kozjak. Një tjetër objekt i rëndësishëm hidrografik është burimi Rashçe prej ku qyteti i Shkupit dhe vendbanimet përreth furnizohen me ujë të pijshëm. Në rajonin e Shkupit ekziston një banjë, e ajo është Banja e Katllanovës.

Monumentet e njohura kulturore dhe historike në Shkup janë: Vendbanimi neolitik Maxhari, Skupi, Kalaja e Shkupit, Çarshia e vjetër, akuadukti romak, Ura e Gurit, xhamia e Mustafa Pashës e ndërtuar në vitin 1492, xhamia e Sulltan Muratit, xhamia e Jahja Pashës, medreseja e Gazi Isa Beut, Kulla e Sahatit me lartësi prej 40 metrave e shekullit XVI, që gjendet në oborrin e xhamisë Sulltan Murat, hamami i Daut Pashës Çifte hamami, Suli Hani, Kurshumli Hani, Kapan hani, Bezistani, Kulla Feudale, manastiri shën. Panteleimoni në Nerez, manastiri i shën. Andresë në Matkë, shën Spasi, shën. Dhimitri, shën. Gjorgji, kisha e madhe shën. Klimenti i Ohrit, etj..

Monumente dhe objekte memoriale: Monumenti i Nënë Terezës, monumenti i çlirimtarëve të Shkupit, monumenti i Goce Dellçevit, Skenderbeu, Porta "Makedonija" e ndërtuar në vitin 2012, "Ushtari mbi kalë" - një monument me një shatërvan i ndërtuar në vitin 2011, monumenti i Filipit të Dytë me një shatërvan, "Kryqi i Mijëvjeçarit" i ndërtuar në vitin 2000, Dame Gruevi, Car Samoili, Petar Karposhi, Nikola Karevi, Qirili dhe Metodi, Kliment dhe Naum të Ohrit, Metodija Andonov Çento, Hristo Uzunov, Kërste Petkov Misirkov, Gjorgjia Puleski Gjorçe Petrovi, Gemixhinjtë, Dositej, Dimitrija Çupovski, monumenti për luftëtarët e rënë, çlirimtarët e Shkupit dhe shumë të tjerë.



Qyteti disponon me këto muze, dhoma përkujtimore dhe institucione kulturore kombëtare: Muzeu Arkeologjik, Muzeu i Luftës maqedonase, Muzeu i Shkencave Natyrore dhe Zoologjik, Muzeu Etnologjik, Muzeu Arkeologjik, etno fshati maqedonas, Shtëpia përkujtimore e Nënë Terezës, muzeu i Holokaustit, muzeu i qytetit të Shkupit, muzeu i Artit Bashkëkohor, teatri Kombëtar Maqedonas, Opera dhe Baleti Maqedonas, Biblioteka Universitare, Salla Universale, disa universitete dhe një duzinë institucionesh të tjera kombëtare.

Ngjarje dhe manifestime: Festivali i Xhazit në Shkup, Festivali i Filmit në Shkup, Vera e Shkupit, Mbrëmjet e Operës së Majit, OFF Fest, Basker Fest, Fest Birra, Vera Skop, Nata e Bardhë, Teatri i Hapur i Rinisë dhe shumë të tjerë.

Në aspekt të komunikacionit rajoni i Shkupit është i lidhur në mënyrë mjaft efikase. Në fakt, këtu gërshetohen rrugët më të rëndësishme të rrjetit rrugor dhe atij hekurudhor, si dhe aeroporti ndërkombëtar "Shkupi". Në Shkup ekzistojnë mbi 150 hotele, hostele, vila, apartamente, konvikte, etj. Qyteti disponon me një numër i madh të restoranteve dhe kafeneve, si rreth 200 agjenci udhëtimesh, restorante të veçanta, bujtina, qebaptore, piceri, furra buke, ëmbëltoje, pube, kafe-bare, klube, diskoteka, terrene lojërash dhe të ngjashme. Në periudhën e kaluar, turizmi është identifikuar si një nga përparësitë themelore të qytetit të Shkupit. Përfitimet e përgjithshme të degës turistike paraqesin segmentin më të rëndësishëm në zhvillimin e përgjithshëm ekonomik dhe shoqëror të qytetit.



METODOLOGJIA GJATË HARTIMIT TË STRATEGJISË

Strategjia për zhvillimin e turizmit në komunën e Studeniçanit përmban më shumë qëllime si paraqitje të vlerave turistike natyrore dhe antropogjene, shërbimeve, aktiviteteve dhe llojeve të turizmit që mund të zhvillohen. Strategjia është një dokument i rëndësishëm që i orienton potencialet dhe mundësitë për zhvillim të qëndrueshëm të turizmit në këtë zonë. Metodologjia e hartimit të strategjisë buron nga qëllimet e paraqitura. Hapat që janë ndërmarrë gjatë zhvillimit të strategjisë janë si më poshtë: inicim të bashkëpunimit; realizim të takimeve dhe vendosje të qëllimeve për hartim të strategjisë për turizëm në komunën e Studeniçanit; formim të një ekipi, rishikimi i literaturës dhe hulumtime në terren; organizimi i punëtorive me palët e interesuara; shkrim, dizajn dhe prezantimin të strategjisë si dhe miratimin e strategjisë. Paraqitja skematike e hapave në përgatitjen e strategjisë për zhvillimin e turizmit në komunën e Studeniçanit, vijon në diagramin e mëposhtëm.

Diagrami 1. Hapat në përgatitjen e një Strategjie për zhvillimin e turizmit në komunën e Studeniçanit.



Gjatë përgatitjes së strategjisë janë përdorur metodat dhe instrumentet kërkimore si në vijim: analiza e përmbajtjes së planeve dhe strategjive evropiane dhe atyre botërore për zhvillimin e turizmit; analiza e rregullave ligjore që ndërlidhen me veprimtaritë turistike dhe hotelierike; analiza e raporteve statistikore në lidhje me hotelierinë dhe turizmin; hulumtim cilësor (punëtori dhe fokus grupe); realizimi i intervistave të pastrukturuara; të menduarit kreativ; kërkime në terren duke fotografuar; analiza në kabinet të literaturës përkatëse, bibliografisë dhe burimeve të internetit; analiza hartografike; 6A kornizë për analizën e destinacionit, analizën SWOT, analiza, analiza cost-benefit, etj. Strategjia është hartuar në përputhje me politikën ekzistuese të turizmit në vendin tonë, duke i konsultuar planet, programet dhe strategjitë përkatëse, ndërsa më të rëndësishme vijojnë më poshtë:

Me karakter nacional: Strategjia nacionale për bujqësinë dhe zhvillimin rural 2014-2020; Strategjia e zhvillimit rajonal 2009-2019; Strategjia Kombëtare për Zhvillimin e Turizmit të Republikës së Maqedonisë së Veriut 2016-2020; Strategjia Kombëtare për Zhvillimin e Turizmit Rural 2012-2017; Strategjia Kombëtare për Zhvillimin e Turizmit Shëndetësor 2012-2018; Nën-strategjia për zhvillimin e turizmit sportiv, me plan veprimi 2015-2018; Nënstrategjia për tradita dhe ngjarje.

Në nivelin rajonal: Strategjia Rajonale për inovacione - rajoni planifikues i Shkupit; Programi për zhvillimin e rajonit planor të Shkupit.

Në nivelin lokal: Strategjia për planin e integruar për zhvillim lokal të komunës së Studeniçanit 2019-2022; Strategjia për përfshirjen sociale, mbrojtje sociale dhe ulje të varfërisë në komunën e Studeniçanit; Strategjia për ndryshime klimatike në komunën e Studeniçanit 2015-2015.

Në hapat e hartimit të strategjisë, janë marrë parasysh interesat e palëve të interesuara, si:

- Banorët vendas të cilët jetojnë ose punojnë në destinacion dhe sigurojnë burime lokale për vizitorët;
- Komuniteti i biznesit që është i interesuar për zhvillimin e destinacionit turistik meqë siguron produkte dhe shërbime turistike;
- Sektori publik që është i interesuar për punësim, për të inkurajuar zhvillimin rajonal dhe për rritjen e të ardhurave të përgjithshme dhe ka një rol të rëndësishëm në zhvillimin e destinacionit turistik;
- Pjesëmarrës të tjerë si organizata joqeveritare, asociacione, investitorë, zanatçinjë, etj;
- Vizitorë dhe turistë (ekzistues dhe potencial) të cilët i shfrytëzojnë produktet dhe shërbimet turistike në destinacion.
- Përkufizimet e përdorura në strategji për terma të caktuar që lidhen me turizmin dhe turistët janë si më poshtë:

Përkufizimet të cilat përdoren në strategji për terma të caktuar që ndërlidhen me turizmin dhe turistët janë si më poshtë:

- Turist vendas është personi me vendbanim të përhershëm në Republikën e Maqedonisë së Veriut i cili qëndron përkohësisht në një vend tjetër nga vendi i tij i qëndrimit të përhershëm dhe kalon të paktën një natë në një hotelieri ose në ndonjë objekt tjetër për akomodim për turistë;
- Turist i huaj është personi me vendbanim të përhershëm jashtë Republikës së Maqedonisë së Veriut i cili përkohësisht banon në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe kalon së paku një natë në një hotel ose në një objekt tjetër akomodimi për turistë;
- Vizitor është personi i cili qëndron në destinacion që nuk është vendbanimi i tij i përhershëm në një interval kohor prej disa orësh pa kaluar një natë;
- Destinacion turistik është një zonë gjeografike në të cilën ekzistojnë të gjitha mundësitë (ose kushtet) të cilat janë të rëndësishëm për një pushim (peizazhi, flora, fauna, kushtet klimatike, atraksionet, objektet e akomodimit, lokalet dhe objektet argëtuese) dhe
- Atraksioni turistik është një vend me interes të cilin turistët zakonisht e vizitojnë për shkak të vlerës së tij kulturore, domethënies historike, bukuri së natyrore ose të ndërtuar, ose mundësive për argëtim.

TË DHËNA PËR TURIZMIN


Turizmi sot paraqet një fenomen të llojit të vet, dukuri që është i pranishëm në të gjitha vendet e botës dhe shënon rritje gjithnjë e më të lartë në nivel global. Nuk ekziston vend në botë që nuk zhvillon ndonjë lloj turizmi ose shtet ku qytetarët nuk janë të përfshirë në udhëtime dhe lëvizje turistike jashtë vendbanimit të tyre të përhershëm. Përfshirja e turistëve në udhëtime është për arsye të ndryshme siç është biznesi, kënaqësia, feja, sporti dhe rekreacioni ose arsye të tjera. Rolin e madh që përmban turizmi, si në aspekt të prosperitetit kulturor, ashtu edhe për shkak të përfitimeve ekonomike për destinacionet, do t'a argumentojmë me të dhënat e siguruar të cilat i ofron Organizata Botërore e Turizmit pranë Kombeve të Bashkuara:

- arritja e turistëve në vitin 2018 në nivelin ndërkombëtar mbërriti numrin prej 1.451 milionë;
- konsumi turistik ishte 1.451 miliard dollarë amerikanë;

- industria e turizmit mori pjesë me rreth 10% në prodhimin e brendshëm bruto global dhe
- çdo i dhjetë person i punësuar në botë, është i punësuar në këtë sektor.

Të dhënat me të cilat disponojmë tregojnë një trend të rritjes së vazhdueshme të udhëtimeve dhe turizmit në 60 vitet e kaluara, ndërsa parashikimet lëvizin në drejtim të vazhdimin të kësaj tendence në të ardhmen. E shprehur në përqindje, në vitin 2018 ka një rritje prej 5% të numrit të përgjithshëm të turistëve e llogaritur nga viti 2010 me një rritje të njëkohshme të të ardhurave prej 5%. Nga kontinentet në botë, Evropa mban rolin kryesor me rreth 51% të pjesëmarrjes në qarkullimin turistik, si nga dërgimi ashtu edhe nga pritja e turistëve.

Republika e Maqedonisë së Veriut si pjesë e familjes evropiane ndjek këtë trend në rritje të turizmit ndërkombëtar dhe si konfirmim i kësaj ne marrim parasysh të dhënat nga Zyra Shtetërore e Statistikave të Republikës së Maqedonisë së Veriut që ndërlidhen me turizmin të cilat tregojnë këtë që vijon:



Nga grafikoni 1 mund të konstatojmë se numri i turistëve në Maqedoninë e Veriut në vitet e fundit shënoi rritje të vazhdueshme, kështu që në vitin 2010 numri i turistëve ishte 586.241, ndërsa në vitin 2019 numri u rrit në 1.189.463, që është për 102 % më shumë. Sa iu përket turistëve vendas, numri i tyre në vitin 2010 ishte 324.545, ndërsa në vitin 2019 arriti në 427.370 ose 32 % më shumë. Në vitin 2010 vendin tonë e vizituan 261.696 turistë të huaj, ndërsa në vitin 2019 numri i tyre ishte 757.593 ose ky numër u rrit për 189%. Nga kjo mund të konkludohet se vitet e fundit numri i turistëve të huaj po rritet në mënyrë mjaft të shpejtë, ndërsa numri i turistëve vendas, edhe pse shënon rritje, është akoma i pakënaqshëm. Në këtë drejtim, bartësit e politikës së turizmit në vend duhet të zhvillojnë strategji për rritjen e numrit të turistëve vendas, por edhe për tërheqjen e më shumë vizitorëve të huaj.

Në aspekt të numrit të bujtjeve të realizuara në periudhën e analizuar, mund të thuhet se ky numër në vitin 2010 arrinte deri në 202.0217, ndërsa në vitin 2019 arriti në 3.262.398 bujtje, që është për 61.5 % më shumë. Turistët vendas në vitin 2010 gjithsej realizuan 1.461.185 bujtje, ndërsa në vitin 2019 u realizuan 1.684.627 bujtje, që është për 13.3 % më shumë. Nga ana tjetër, turistët e huaj

në vitin 2010 gjithsej realizuan 559.032 bujtje, ndërsa në vitin 2019 ky numër arriti në 1.577.771, që do të thotë se u rrit për 182.82%. Ashtu si edhe me numrin e vizitorëve, dukshëm është rritja e numrit të bujtjeve të realizuara nga turistët e huaj, në llogari të bujtjeve nga turistët vendas. Në këtë drejtim janë të nevojshme analiza gjithëpërfshirëse për të marrë masa në aspekt të zgjatjes së qëndrimit të turistëve vendas, por edhe për t'a mbajtur trendin e rritjes së numrit të bujtjeve të realizuara të vizitorëve të huaj në vendin tonë.

Tabela 1: Numri i bujtjeve të realizuara në Republikën e Maqedonisë së Veriut 2014-2019

	2014	2015	2016	2017	2018	2019
Gjithsej	2.195.883	2.394.205	2.461.160	2.775.152	3.176.808	3.262.398
Vendas	1.273.370	1.357.822	1.407.143	1.480.460	1.685.273	1.684.627
Të huaj	922.513	1.036.383	1.054.017	1.294.692	1.491.535	1.577.771

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut, destinacionet kryesore të cilat tërheqin turistë, janë liqenet, vendpushimet malore, banjat termalë, rajonet ku prodhohet verë, si dhe qyteti i Shkupit. Numri i turistëve sipas rajoneve është paraqitur në tabelën nr. 2. Në periudhën e analizuar, numri i turistëve në rajonin e Vardarit shënoi rritje të vazhdueshme, kështu që në vitin 2010 ai numër ishte 10.572, ndërsa në vitin 2019 u rrit në 25.136, që është për 150% më shumë.

Tabela 2: Numri i turistëve sipas rajoneve në Republikën e Maqedonisë së Veriut 2010-2019


Rajonet	2010	2013	2016	2019
E Vardarit	10.572	17.196	26.064	25.136
Lindor	13.054	20.747	30.568	32.077
Jugperëndimor	234.665	264.826	322.334	445.846
Juglindor	84.856	109.982	135.092	167.451
I Pellagonisë	69.712	70.312	58.355	72.833
I Pollogut	31.828	30.823	27.318	41.994
Verilindor	3.098	5.584	9.774	10.444
I Shkupit	138.456	182.324	247.338	389.182

Numri i turistëve në zonën lindore, në vitin 2010 ishte 13.054, ndërsa në vitin 2019 ky numër arriti në 32.077 ose për 145% më shumë. Në vitin 2010 rajoni jugperëndimor u vizitua nga gjithsej 234.665 turistë, dhe i njëjti numër në vitin 2019 arriti në 445.846, që është për 90% më i lartë. Rajoni juglindor në vitin 2010 u vizitua nga gjithsej 84.856 turistë, ndërsa në vitin 2019 nga gjithsej 167.451 turistë, gjë që është për 97.3% më shumë. Rajoni i Pellagonisë në vitin 2010 kishte 69.712 vizitorë, ndërsa në vitin 2019 ky numër u rrit në 72.833 ose vetëm për 4.5% më shumë. Rajonin e Pollogut në vitin 2010 e vizituan 31.828 vizitorë, ndërsa në vitin 2019 këtë rajon e vizituan 41.994 vizitorë ose për 31.9% më shumë. Rajoni verilindor në vitin 2010 u vizitua nga gjithsej 3.098 turistë, ndërsa në vitin 2019 ky rajon u vizitua nga 10.444 turistë ose për 237% më shumë. Në rajonin e Shkupit në vitin 2010 kishte gjithsej 138.456 turistë, ndërsa në vitin 2019 gjithsej pati 389.182 turistë ose 181% më shumë.

Tabela 3: Numri i turistëve në rajonin e Shkupit 2010-2019

	Gjithsej	Vendas	Të huaj
2010	138.456	23.793	114.663
2011	154.163	23.437	130.726
2012	164.077	25.088	138.989
2013	182.324	27.433	154.891
2014	196.087	28.050	168.037
2015	234.123	29.954	204.169
2016	247.338	29.540	217.798
2017	324.146	36.937	287.209
2018	367.597	46.155	321.442
2019	389.182	47.019	342.163

Në tabelën numër 3 janë paraqitur disa të dhëna statistikore për numrin e turistëve në rajonin e Shkupit, ku bën pjesë edhe komuna e Studeniçanit të periudhës nga viti 2010, deri në vitin 2019. Këtu mund të shihet se me kalimin e viteve ekziston një trend i rritjes së këtij numri në mënyrë të vazhdueshme, kështu që në vitin 2010 rajoni i Shkupit u vizitua nga gjithsej 138.456 turistë, ndërsa nëntë vite më vonë, ky rajon u vizitua nga 389.182 turistë, që është për 181% më i lartë. Lidhur me turistët vendas, numri i tyre në vitin 2010 ishte 23.793, ndërsa në vitin 2019 arriti në 47.019, që është pothuajse dy herë ose më saktë për 97% më i lartë, ndërsa te turistët e huaj ky numër u rrit nga 114.663 në vitin 2010, në 342.163 në vitin 2019, që është për rreth 198% më shumë. Përkundër trendit të rritjes së vazhdueshme të numrit të turistëve në rajon, ndryshimi në numrin e turistëve vendas dhe të huaj është i dukshëm. Në periudhën e analizuar numri i përgjithshëm i turistëve vendas ishte 317.406, ndërsa numri i turistëve të huaj ishte 2.080.087, që është për 6.5 herë më shumë. Paraqitja e një oferte të larmishme dhe autentike turistike, arritja e një çmimi konkurrues, promovimi adekuat, etj., janë vetëm disa nga aktivitetet të cilat bartësit e politikës turistike duhet t'i zbatojnë për ta mbajtur trendin pozitiv dhe rritjen e numrit të turistëve dhe natyrisht, për të tërhequr turistë vendas.



Në grafikonin 5 është paraqitur numri i bujtjeve të realizuara nga turistë vendas dhe të huaj në rajonin e Shkupit gjatë periudhës kohore të viteve 2010 deri në vitin 2019. Këtu mund të shihet se në periudhën e analizuar ekziston një trend i rritjes së vazhdueshme, kështu që në vitin 2010 në këtë rajon janë realizuar gjithsej 305.345 bujtje, ndërsa nëntë vite më vonë, ky numër arriti në 688.324 bujtje, gjë që është rreth 125% më shumë. Nga gjithsej 4.626.878 bujtje në periudhën e analizuar, turistët vendas kanë realizuar 1.049.792 bujtje, ndërsa turistët e huaj 3.577.086 bujtje, pra rreth 240% më shumë. Zgjatja e qëndrimit të turistëve në çdo rast ka të bëjë me atraktivitetin, diversitetin dhe cilësinë e ofertës turistike në rajon, si dhe me gatishmërinë e të gjitha palëve për të marrë pjesë në mënyrë aktive në hartimin dhe realizimin e shërbimeve turistike.

Tabela 4: Kapacitetet hotelierike në komunën e Studeniçanit (2016):

Objektet për akomodim	Numri i dhomave	Numri i shtretërve	Numri i të punësuarve	Objektet hotelierike	Numri i ulësëve	Numri i të punësuarve
1	64	128	20	29	981	87

Burimi: Enti Shtetëror për statistikë (2016), Regjistrimi i kapaciteteve hotelierike në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Shkup: Enti Shtetëror për statistikë.

Në tabelën numër 4 janë paraqitur kapacitetet hotelierike të komunës së Studeniçanit. Këto të dhëna tregojnë se komuna (në vitin 2016) disponon më 1 objekt akomodimi, me 64 dhoma në të cilat ekzistojnë 128 shtretër me 20 të punësuar. Në komunë gjithsej ekzistojnë 29 objekte hotelierike me një kapacitet prej 981 ulëse dhe 87 të punësuar.

TRENDET BASHKËKOHORE NË TURIZËM

Strategjia për turizëm në komunën e Studeniçanit synon t'i përfshijë nevojat aktuale dhe trendet moderne në tregun e turizmit në botë, dhe të njëjtat janë paraqitur përmes zgjidhjeve reale që i marrin parasysh potencialet dhe mundësitë e komunës. Trendet globale që parashikohet të kenë një rëndësi të madhe në zhvillimin e ardhshëm të turizmit, janë këto në vijim:

Të gjitha aspektet që ndërlidhen me shëndetin (fitnes-palestër, banjë, aktivitete fizike, etj.), në një të ardhme të afërt do të kenë rëndësi shtesë. Megjithëse rritja e ndërgjegjësimit për shëndetin nuk do të ndikojë në zgjerimin e kërkesave, kjo me siguri do të ndikojë në sjelljen e vendimeve në lidhje me destinacionet dhe sjelljet dhe aktivitetet gjatë pushimeve. Në këtë segment karakteristik është rritja e konkurrencës, me investime të kapitalit privat në azhurnimin e banjove të vjetra termale shëndetësore dhe banjove qendrore termale rekreative.

Shoqëria bashkëkohore e rrit presionin ndaj jetës së përditshme të njerëzve dhe e inkurajon dëshirën për më shumë kohë të lirë për pushim dhe relaksim - gjë që do të ketë një efekt negativ në rritjen e të ardhurave të lira. Sipas definicionit, ky trend për turizmin nuk është i mjaftueshëm.

Konsumatorët më të sofistikuar janë gjithnjë e më të sigurt në raport me nevojat dhe të drejtat e tyre. Për turizmin kjo rezulton në një qëndrim gjithnjë e më kritik ndaj cilësisë dhe raportit të çmim-kualitet.

Përdorimi i internetit me qëllim që të blihet dhe të krahasohen produktet dhe shërbimet turistike vazhdimisht do të rritet. Si rezultat i kësaj, konsumatori do të marrë gjithnjë e më tepër kontroll. Do të programohen sisteme të reja për pagesa elektronike, kartela të sigurta kreditore, portofol elektronik, etj. Këto arritje do të bëjnë që transferimet e parave të realizohen në mënyrë shumë më të lehtë, si dhe të tejkalohen shqetësimet në lidhje me pagesat e tepërta të transferit, kurset e këmbimit dhe sigurinë.

Në të ardhmen njerëzit do të jetojnë më gjatë, e me këtë grupmoshat më të vjetra do të rriten. Këta seniorë të "shëndoshë" do të kenë më tepër kohë të lirë. Por gjithashtu, segmenti rinor (16-35 vjeç), ku bën pjesë më shumë se 20% të turizmit global, është një grup i rëndësishëm i synuar për të ardhmen.

Ndryshimet klimatike ndikojnë, madje edhe iu kanosen disa qendrave të caktuara turistike, të cilat varen nga mjedisi i tyre natyror. Zvogëlimi i akullnajave në Evropë është vetëm një argument për ngrohjen globale. Prapëseprapë, për efektet reale nga ndryshimi i klimës akoma ekzistojnë dyshime.

Ekonomia globale edhe më tej do të vazhdojë të rritet. BRIC ekonomitë, Brazili, Rusia, India dhe Kina, me siguri se do të jenë kombet me rritjen më të shpejtë në botë. Tregtia globale me mallra dhe shërbime të konsumit edhe më tej do të vazhdojë të rritet. Shërbimet (përfshirë këtu edhe turizmin) do të bëhen të rëndësishme në ekonominë botërore.

Shpenzimet për shërbimet sociale, shëndetësore, arsimore, pensionet dhe shërbime të tjera, në të ardhmen do të rriten që do t'i detyrojë qeveritë t'i rrisin tatimet. Shqetësimet në lidhje me çështjet e sigurisë, shëndetit dhe imigracionit, do të shkaktojnë kontrolle më të mëdha të udhëtimeve nga ana e qeverive.

Sulmet terroriste ndaj turistëve dhe destinacioneve turistike shkaktojnë një ndjenjë më të madhe të pasigurisë, ndërsa mediat në mënyrë plotësuese ndikojnë në rritjen e frikës nga këto kërcënime. Gjithashtu, fatkeqësitë natyrore të cilat duket se ndodhin më shpesh sesa në të kaluarën, dukshëm e dëmtojnë turizmin. Prapëseprapë, është argumentuar se diapazoni i vëmendjes së konsumatorit është relativisht i ulët, e kjo ndodh meqë njerëzit e dinë se nuk mund të bëjnë asgjë në lidhje me këtë.

Siguria shëndetësore është një faktor i rëndësishëm për zhvillimin e turizmit. Kriza me virusin KOVID-19 ka kontribuar në zvogëlimin dhe kufizimin e lëvizjes së turistëve dhe supozohet se kriza të tilla shëndetësore dhe të ngjashme në të ardhmen do të ndryshojnë mënyrën e udhëtimeve dhe kulturën e sjelljes së turistëve.



Në të ardhmen pritet të ketë më pak ndryshime në destinacione. Vendet unike gjithnjë e më tepër do të zhduken. Në të kaluarën udhëtimi ishte një luks, por sot është pjesë normale e jetës. Numri i pushimeve është duke u rritur, ndërsa kohëve të fundit edhe ai i udhëtimeve të shkurtra. Liria për të udhëtuar do të zgjerohet te prindërit më të vjetër dhe rritja e familjeve me njërin prind. Grupet e reja të komuniteteve që kanë interesa të përbashkëta shumë shpejtë bëhen burim kryesor të njohurive të orientimit, argëtimit dhe sigurisë. Në vendet e huaja ekziston një kërkesë më të lartë për produktet që ofrojnë gjendje të mirë, shëndet dhe fitnes, menaxhim me stresin, si dhe shërbime mjekësore. Konsumatorët kërkojnë këshilla nga përdoruesit tjerë përmes internetit.

Ka të ngjarë që konsumatorët e kualifikuar të dinë më shumë për produktet specifike, sesa ekspertët e udhëtimit. Gjithashtu, do të ketë investime të larta në internet-strategjitë për promovim dhe në teknikat e reja të hulumtimeve. Partneritetet publike private bëhen më të rëndësishme për marketingun e turizmit, meqë qeveritë përpiqen që të rritet përfshirja e aksionerëve dhe e buxhetit të marketingut.

Veturat janë mjete të transportit në 70% të të gjitha udhëtimeve turistike, dhe ato do të mbeten mjete më të rëndësishme të transportit. Qasja e ulët deri në qendrat e qyteteve dhe transporti i lirë ajror, kanë një ndikim negativ në udhëtimet me autobusë. Gjithashtu, rritja e udhëtimit ajror mund të ulet për shkak të kostove të karburantit, sigurisë dhe taksave të aeroportit. Qeveritë janë duke investuar gjithnjë e më shumë para në udhëtimet përmes hekurudhës, veçanërisht në ekspres-linjat.

VIZIONI PËR TURIZMIN NË KOMUNËN E STUDENIÇANIT

Gjatë hartimit të dokumenteve të menaxhimit, një pjesë përbërëse e strategjive është edhe vendosja e vizionit dhe misionit si bazë për zhvillimin e mëtejshëm.

Studenicaani është një komunë bashkëkohore rurale e njohur për turistët me pasuritë e saj natyrore dhe kulturore, si një destinacion për pushim dhe rekreacion. Misioni i kësaj strategjie është kjo që vijon: Rritja e përfitimeve sociale dhe ekonomike në territorin e komunës të cilat burojnë nga turizmi.

KARAKTERISTIKAT E KOMUNËS SË STUDENIÇANIT

Karakteristikat e komunës së Studenicaanit janë përfshirë përmes përpunimit të materialit që ndërlidhet me zhvillimin historik të komunës, ueb portalin, biznes sektorin, të dhënat gjeografike dhe ato demografike, arsimin, komunat e vëllazëruara dhe lidhjen e komunikacionit.

PËRGJATË HISTORISË

Fushëgropa e e Shkupit në të cilën gjendet ndodhet Rajoni Planifikues i Shkupit, ku sot bën pjesë Komuna e Studenicaanit, dikur, ashtu si edhe sot, kishte një pozitë qendrore brenda Ballkanit të Mesëm. Në një të kaluar të largët, fushëgropa e Shkupit shtrihej në pjesën e mesme midis rrjedhës së Vardarit dhe Moravës si një udhëkryq të rrugëve të mëdha kryesore nga veriu në drejtim të jugut dhe nga perëndimi drejt lindjes si një lidhje midis Kosovës fushëgropave maqedonase të perëndimit në një rën anë dhe luginat maqedonase në anën tjetër. Nga kjo lind rëndësia qendrore gjeopolitike e fushëgropës së Shkupit që kishte ndikim të madh historia politike dhe ajo kulturore të kësaj zone, ashtu si edhe në kontaktet dhe ndikimet e rajoneve të tjera të rëndësishme nga e kaluara.

Para ardhjes së romakëve, përkatësisht në shek. V dhe IV para erës së re, kishte përpjekje për t'i urbanizuar vendbanimet dhe u ndërtuan vendbanime të fortifikuara që mbështeteshin në përvojat helene dhe në shembujt nga Egjeu dhe Mesdheu Lindor. Këto vendbanime përpiqeshin për renditje të planifikuara të hapësirës së brendshme, për përdorimin maksimal dhe funksional të saj, për formësim estetik, e nga ana tjetër për fortifikim më kualitativ dhe më efikas. Nga kjo periudhë daton edhe qyteza Isar/Kalaja afër vendbanimit Studenicaan. Muret mbulonin një sipërfaqe prej 2.5 hektar, por pasuria e gjetur e tundshme e veçon atë nga lokalitetet tjera në rajonin e Shkupit - përveç bizhuterive, vazove luksoze të bëra prej argjendi dhe bronzi, vazo të pikturuara të tipit antik, armë, pitose të mëdha, këtu është vërtetuar edhe prodhimi vendor të vazove të pikturuara sipas modeleve të mallrave të importuara nga jugu. Gjithashtu, në Studenicaan janë gjetur edhe dekorime ballore (të fytyrës dhe ballit) në formën e motiveve të zbukuruar që qëndronte mbi shtëpi të ashtuquajtura antefikse.

Përveç qytezës në Studenicaan, në territorin sotëm të komunës së Studenicaanit ekzistojnë edhe lokaliteti Vranjak në Markova Sushicë.

Me epokën romake dhe me ardhjen e romakëve në shek. III dhe II para erës së re filloi urbanizimi i vërtetë i zonës së fushëgropës së Shkupit. Qytetet të cilët lindën në atë kohë u ndërtuan sipas standardeve italo-romake me skemë të caktuar të brendshme, me një renditje në ndërtesave publike, me sistem komunal-higjienik, me rrugë të shtruara me pllaka, kanalizime, ujësjellës, etj.

Është e njohur në histori se romakët i kushtonin rëndësi të veçantë ndërtimit dhe mirëmbajtjes së rrugëve. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për rajonin e Shkupit, meqë rrugët e ndërtuara nga romakët u shfrytëzuan deri në periudhën e vonshme romake dhe në periudhën e hershme bizantine, kështu që duke e kushtëzuar zhvillimin ekonomik dhe kulturor të rajonit - u ndërtuan qendra tregtare aty ku gërshetoheshin rrugët ku edhe u ngritën kulla të rojeve dhe qytete të fortifikuara, farkëtari, etj. Në periudhën nga shek. I e deri në shek. VI të erës së re, në territorin e komunës së sotme të Studeniçanit, u ngritën një varg vendbanimesh dhe fortesash të cilat tregojnë për popullimin e vazhdueshëm të kësaj zone, si dhe për zhvillimin e hershëm të popullatës së asaj kohe. Vendbanimet dhe fortifikatat e këtilla janë siç vijon: "Kalaja" dhe "Mumxhica" në fshatin Alldincë, "Gradishte" në fshatin Koliçan i Poshtëm, "Kalaja" në fshatin Dracevicë, "Isari" në fshatin Ellovë, "Kalaja" në fshatin Maja e Zezë, etj.

Gjatë periudhës së shtrirjes së sllavëve në këto zona, nuk ekzistonin kurrfarë gjetje të shkruara ose gjurmë kulturore. Historia e shekullit të mesëm për rajonin e Shkupit fillon në fund të shek. X-të me mbretërimin e Car Samoilit, përkatësisht atëherë kur Shkupi dhe zona përreth ishin një pikë e rëndësishme strategjike dhe mbrojtëse. Me fitoren përfundimtare të Bizantit mbi Car Samoilin, Shkupi dhe zona përreth u bë një vend i rëndësishëm i një njësie më të madhe administrative - temë.

Periudha nga shek. X-të e deri në shek. XIV-të, përkatësisht periudha bizantine-sllave, ka një domethënie të veçantë për historinë mesjetare të këtij rajoni. Rëndësia ekonomike e Shkupit është veçanërisht e rëndësishme, meqë Shkupi ishte një bastion strategjik dhe kufitar. Disa rrugë rajonale kryqëzoheshin në rajonin e Shkupit, ndërsa Shkupi ishte një ekspoziturë bizantine ndërkuftare drejt Evropës dhe një qendër e rëndësishme tregtare ballkanike. Shkupi i atëhershëm kishte dy forma të qeverisjes: pjesën ushtarake-administrative dhe pjesën civile. Prej tyre varej edhe trashëgimia kulturore dhe ajo shpirtërore.

Periudha bizantine e Komnenit të shek. XII, është unik sipas stilit të saj të arritjeve në mbarë Ballkanin, dhe deri më sot tërheq interes të vazhdueshëm. Në periudhat e mëvonshme karakteristike janë vendet e shenjta shpirtërore të krishtera në stilin e bazilikës dhe bazë të një kryqi të gdhendur.

Por një gjë është e rëndësishme të thuhet për periudhat pas Bizantit: Me forcimin e Shkupit si një qendër strategjike ekonomike dhe politike, do të neglizhohen ose do të lihen pas dore zonat periferike të Shkupit ku bën pjesë edhe komuna e sotme e Studeniçanit.

Pas Luftës së Dytë Botërore dhe formimit të Jugosllavisë së re, territori i komunës së sotme të Studeniçanit, iu bashkëngjit komunës së atëhershme të Kisella Vodës. Në shtator të vitit 1996 u miratua Ligji për Ndarjen e Re Territoriale të Republikës së Maqedonisë, sipas së cilit nga 34 komunat e deriatëhershme u formuan 123 komuna, si dhe qyteti i Shkupit me Asamblenë e Qytetit. Nga komuna e asaj kohe e Kisella Vodës, lindën edhe tre komuna të reja, edhe atë: komuna e Zelenikovës, komuna e Studeniçanit dhe komuna e Sopishtës.

WEB PORTALI

Komuna e Studeniçanit menaxhon me një ueb faqe zyrtare ku shfaqen të gjitha informatat e rëndësishme që ndërlidhen me funksionimin dhe veprimtarinë e komunës, e që është në interes të qytetarëve, të biznes-grupeve, të investitorëve të ardhshëm, vizitorëve, si dhe në interes të palëve tjera të interesuara.

<http://www.studenicani.gov.mk>

GRUPI I BIZNESIT

Në territorin e komunës ekzistojnë rreth 240 subjekte afariste aktive si në vijim: prodhim bujqësor, miniera, industria përpunuese, ndërtimtari, tregti, transport, hotelieri, etj. Popullsia në komunën e Studeniçanit kryesisht merret me tregti, ndërtimtari, industri përpunuese, transport, etj. Nga gjithsej 240 objekte aktive të punës, 153 janë mikro, 83 të vogla, 3 të mesme dhe 1 objekt i madh biznesi.

Tabela 5. Numri i subjekteve afariste aktive në komunën e Studeniçanit (2016).

Nr. rendor	Sektorët e veprimtarive sipas klasifikimit Nacional të veprimtarive	Numri i subjekteve aktive të veprimtarive në vitin 2016
1.	Bujqësia, pylltaria dhe peshkimi	4
2.	Miniera dhe nxjerrja e gurëveve	2
3.	Industria përpunuese	26
4.	Furnizimi me ujë, asgjësimi i ujërave të zeza, menaxhimi me plehrat dhe rehabilitimi i mjedisit	3
5.	Ndërtimtaria	37
6.	Tregtia me shumicë dhe tregtia me pakicë, riparimi i automjeteve dhe motoçikletave	85
7.	Transporti dhe deponimi	24
8.	Objektet e akomodimit dhe veprimtaritë e shërbimit me ushqime	10
9.	Informacione dhe komunikime	2
10.	Veprimtaritë financiare dhe veprimtaritë e sigurimeve	1
11.	Veprimtaritë profesionale, shkencore dhe teknike	3
12.	Veprimtaritë e shërbimit administrativ dhe ato mbështetës	1
13.	Administrata publike dhe mbrojtja, sigurimi i detyrueshëm shoqëror	1
14.	Arsimi	4
15.	Veprimtaritë e mbrojtjes shëndetësore dhe sociale	10
16.	Art, argëtim dhe rekreacion	1
17.	Aktivitete tjera të shërbimit.	5
Gjithsej		522

Burimi: <http://www.stat.gov.mk/Publikacii/SG2017/12-DelovniSubj-BusinessEnt.pdf>

KARAKTERISTIKAT GJEOGRAFIKE

Komuna e Studeniçanit shtrihet në pjesën veriore të Republikës së Maqedonisë së Veriut ndërmjet 41°40` dhe 41°55` SGS dhe 21°20` dhe 21°35` IGD dhe mbulon një sipërfaqe prej 274km², në pjesën jugore dhe jugperëndimore të fushëgropës së Shkupit. Në territorin e kësaj komune buron lumi i Kadiut. Hapësira territoriale e kësaj komune në vete përmban një strukturë të larmishme të relievit, meqë pjesa më e madhe e saj është kodrinore - malore e vendosur midis maleve Goleshnicë dhe Karaxhicë, përkatësisht i përket masivit malor Jakupica. Kjo komunë kufizohet me komunat: Sopishtë, Kisella Vodë, Zelenikovë, Çashkë, Makedonski Brod dhe Petrovec. Territori i Komunës së Studeniçanit përfshin një sipërfaqe prej 274 km² dhe numërohet në komunat e mesme të mëdha në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Dendësia mesatare e popullsisë është 62 banorë për km², që në raport me karakterin kodrinor-malor të komunës është një mesatare relativisht e mirë.

Në përbërje të komunës së Studeniçanit bëjnë pjesë 19 vendbanime, nga të cilat 18 janë ekzistuese - ndërsa një fshat plotësisht është i zhvendosur (fshati Kalldirec). Vendi qendror dhe selia e komunës është në fshatin Studeniçan që numëron 4.582 banorë. Vendbanimet e tjera janë: Batinca, Draçevica, Koliçani i Poshtëm, Koliçani i Epërm, Uji i Kuq, Alldinca, Cvetova, Ellova, Maja e Zezë, Markova Sushica, Vërtekica, Mallçishta, Umova, Pagarusha, Osinçani, Ramni Gaberi dhe Morana. Vendbanimi më i madh është fshati Batincë me 4.109 banorë. Vendbanimi **Studeniçan** - shtrihet në luginën rrëzë malit Kitkë dhe pjesën fushore të Fushës së Shkupit.

Pjesa e vjetër e fshatit është tërhequr në luginën e përroit të Studeniçanit, ndërsa pjesa më e re, përkatësisht në kohët më reja, gjithnjë e më tepër shtëpi janë duke u ndërtuar dhe fshati është duke u zgjeruar në pjesën e rrafshët të Fushës së Shkupit në drejtimin verior dhe veriperëndimor. Studeniçani ndodhet 16km nga Shkupi dhe pothuajse është i bashkuar me vendbanimin Draçevë që gjendet në fqinjësi.

Vendbanimi **Batincë** - Batinca me qytetin dhe komunën është lidhur përmes rrugës së asfaltuar. Vendgrumbullimi i mbeturinave për Batincën është vendi i mbeturinave i quajtur "Drislla", që është gjithashtu një vendgrumbullim i mbeturinave për të gjitha komunat në rajonin planifikues të Shkupit, përfshirë këtu edhe qytetin e Shkupit, dhe ky vendgrumbullim i plehrave është vendosur pikërisht në afërsi të këtij fshati.

Vendbanimi **Moranë** - ndodhet në pjesën lindore të fushëgropës së Shkupit, rrëzë malit Kitkë që është pjesë e masivit të Malit Mokrë. Nga qyteti i Shkupit është 19km larg. Fshati shtrihet në anën e djathtë të rrugës rajonale Draçevë - Zelenikovë. Përmes fshatit Moranë rrjedh përroi i Moranës (përroi i Moranës) që është degë e djathtë e lumit Vardar.

Vendbanimi **Koliçani i Poshtëm** - shtrihet rrëzë malit Kitkë, përkatësisht në zonën e mesme të pellgut të lumit të Markut. Ky fshat ndodhet 18km larg nga qyteti i Shkupit. Për shkak të vendndodhjes së favorshme dhe lidhjes së mirë të komunikacionit me rrugën e asfaltuar me Draçevën, fshati Koliçan i Poshtëm paraqet një lloj qendre për shumë fshatra të afërta dhe më të largëta që shtrihen rrëzë malit Kitkë.

Vendbanimi **Koliçani i Epërm** - me qytetin dhe komunën, Koliçani i Epërm është i lidhur përmes rrugës së asfaltuar.

Vendbanimi **Uji i Kuq** - ndodhet në zonën e mesme të pellgut të lumit të Markut. Fshati është kodrinor, ndërsa lartësia mbidetare është 812m. Qyteti i Shkupit ndodhet në një largësi prej 22km.

Vendbanimi **Kalldirec** - ndodhet në shpatet veriore të Goleshnicës dhe pothuajse është tërësisht i zhvendosur.

Vendbanimi **Aldincë** - shtrihet në rrjedhën e sipërme të lumit të Kadiut në malin Goleshnica. Ky fshat gjendet 41km në jug të Shkupit dhe 35km në jug të qendrës komunale Studeniçan.

Vendbanimi **Pagarushë** - me qytetin dhe komunën fshati Pagarushë lidhet përmes rrugës së asfaltuar.

Vendbanimi **Vërtekicë** - me qytetin dhe komunën fshati Vërtekicë lidhet përmes rrugës së asfaltuar.

Vendbanimi **Ramni Gaber** - fshati Gaber me qytetin e Shkupit dhe komunën është i lidhur përmes rrugës së asfaltuar¹.

Vendbanimi **Draçevicë** - me qytetin dhe komunën fshati Draçevicë është e lidhur përmes rrugës së asfaltuar që të shpie nëpër fshatin Batincë.

Vendbanimi **Umovë** - pothuajse është tërësisht i zhvendosur.

Vendbanimi **Markova Sushicë** - shtrihet në rrugën lokale dhe nga ana e majtë e rrugës rajonale që shkon drejt në zonës Poreçje dhe liqenit artificial Kozjak, ndërsa nga qyteti i Shkupit është në një largësi prej 18 kilometrash. Markova Sushicë shtrihet në një lartësi prej 370 metrash në luginën e lumit të Markut, në bregun e saj të majtë jo shumë larg nga vendtakimit të lumit të Patishkës në lumit të Markut.

Vendbanimi **Mallçishtë** - me qytetin dhe komunën fshati Malçishtë është lidhur përmes një rruge pjesërisht të shkatërruar që të shpie deri në Markova Sushicë. Fshati ndodhet përgjatë rrjedhës së lumit të Markut.

Vendbanimi **Cvetovë** - me qytetin dhe komunën fshati Cvetovë është i lidhur përmes rrugës së asfaltuar që të shpie deri në Markova Sushicë. Fshati Cvetovë ndodhet në pjesën jugperëndimore të fushëgropës së Shkupit në zonën e sipërme të pellgut të lumit të Markut. Ndodhet në shpatin e malit Mokër në pjesën burimore të përroit të Cvetovës, që si degë e djathtë e lumit të Markut derdhet drejtpërdrejt aty në afërsi të manastirit të Markos. Fshati Cvetovë shtrihet në një shpat pak më poshtë majës së quajtur Pijançe (1.170 metra mbi lartësi mbidetare) në Karaxhicë dhe vargmaleve Mokra të quajtur Temna Buka. Sipas kësaj vendndodhje, ky fshat

¹ Në të vërtetë fshati Gaber nuk është i lidhur me rrugë të asfaltuar, por rruga e asfaltuar shtrihet deri në fshatin Vërtakicë. Pjesa e mbetur prej 3.5 km deri në fshat është e shtruar me zhavor.

konsiderohet si vendbanim malor në lartësi prej 820 metrash. Fshati Cvetovë larg qytetit të Shkupit është 33 km.

Vendbanimi **Osinčanë** - ndodhet në zonën qendrore të pellgut të lumit të Markut. Ky fshat shtrihet në shpatin e djathtë në luginën e Patishka Rekës rrëzë maleve Karaxhicë dhe Kitkë. Vendbajimi Osinčanë është fshat malor i vendosur në lartësi mbidetare prej 700 metrash. Ky vendbanim gjendet 18km larg Shkupit, përkatësisht 25km përfshirë këtu edhe 4.5km nga kryqëzimi i rrugëve para minierës së çimentos.

Vendbanimi **Ellovë** - shtrihet në shpatet perëndimore të malit Karaxhicë.

Vendbanimi **Maja e Zezë** - shtrihet në shpatet veriore të malit Jakupicë.

Klima është nën ndikimin e klimatik mesdhetar që bartet përgjatë luginës së Vardarit dhe lumit të Markut dhe kushtëzon një klimë të ndryshuar mesatare-kontinentale me dimra mesatarisht të ftohta dhe verë mesatarisht të nxehtë dhe të thatë. Megjithatë, për sa i përket karakteristikave mikro-klimatike që ndërlidhen me lartësinë mbidetare, në territorin e komunës (së Studeniçanit) dallohen më shumë zona klimatike. Në të vërtetë, në veri të vendbanimit Cvetovë, territori i komunës arrin në një lartësi mbidetare deri në 900 metra, ku mbisundon klimë kontinentale sub-mesdhetare dhe e ngrohtë kontinentale. Në një shirit të ngushtë prej 900 deri më 1.300 metrash mbi nivelin e detit, klima kalon shpejt në një klimë të ftohtë kontinentale dhe nën-malore-kontinentale-malore. Të cilat ndodhen në lartësi prej mbi 1.300 metrash, karakterizohen me klimë malore-kontinentale, që mbi 1.650 metra mbi nivelin e detit, shndërrohet në klimë malore sub-alpine dhe malore alpine. Sipas të dhënave nga Stacioni Meteorologjik Shkup - Petrovec, muaji më i ftohtë i vitit është janari me temperaturë mesatare prej 0.2°C, ndërsa minimumi absolut i matur në janar dhe dhjetor është -25.6° C. Muaji më i ngrohtë është muaji korrik me temperaturë mesatare prej 23.5°C, ndërsa temperatura maksimale e matur në gusht është 30.7°C. Duhet thënë se për shkak të dallimit në lartësi, këto temperatura dukshëm ndryshojnë me rritjen e lartësisë mbidetare, me temperaturë mesatare e cila në dimër është 0.38°C/100 m, ndërsa në verë rritet në 0.65°C/100m. Prandaj, temperatura shumëvjeçare e ajrit që është 12.2°C, me rritjen e lartësisë do të ulet deri në 0°C.

Në komunën e Studeniçanit bien sasi më të mëdha të reshjeve, sesa që paraqitet në tabelën e mësipërme, sepse - ashtu si me temperaturën - edhe reshjet rriten me rritjen e lartësisë mbidetare. Gradienti mujor i reshjeve është shumë i ndryshueshëm për shkak të së cilës mund të pritët që reshjet totale vjetore në territorin e komunës së Studeniçanit të shkojnë nga 600 deri në 800mm, ndërsa shuma mesatare vjetore e tyre është 672.2mm që bien. Më shumë reshje bien në periudhën e vegjetacionit në pranverë, edhe atë gjatë muajit maj, si dhe në vjeshtë në muajin nëntor. Në zonat më të larta, në periudhën e dimrit reshjet shfaqen në formë të borës.

TREGUESIT DEMOGRAFIK

Sipas regjistrimit të fundit zyrtar të popullsisë dhe amvisërive në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në territorin e komunës së Studeniçanit gjithsej jetonin 17.246 banorë, nga të cilët 8.910 të gjinisë mashkullore dhe 8.336 të gjinisë

femërore. Dendësia e popullsisë është 62.45 banorë/km². Sipas vlerësimit nga viti 2018, në komunën e Studeniçanit jetojnë 22.242 banorë.

Sipas strukturës etnike të popullsisë, në komunën e Studeniçanit dominojnë shqiptarët me 11.793 banorë ose 68.4%. Përveç tyre, në këtë komunë jetojnë edhe 3.285 turq (19%), 309 maqedonas (1.8%), ndërsa të tjerët prej 10.8% i përbëjnë boshnjakët, romët, serbët dhe grupe të tjera etnike.

VEPRIMTARIA ARSIMORE

Arsimi fillor në komunën e Studeniçanit është i organizuar në shkollat fillore, si në vijim: Shkolla fillore "Alija Avdoviq" - Batincë dhe shkollat e saj rajonale në vendbanimet: Maja e Zezë, Cvetovë, Ellovë, Mallçishtë dhe Draçevicë; Shkolla fillore "Mustafa Kemal Atatürk" - Koliçani i Poshtëm dhe shkollat e saj rajonale në vendbanimet: Koliçani i Epërm, Vërtekicë dhe Uji i Kuq; Shkolla Fillore "Naim Frashëri" - f. Studeniçan dhe shkolla rajonale në vendbanimin (fshatin) Moranë.

KOMUNAT E VËLLAZËRUARA

Komuna e Studeniçanit është vëllazëruar me komunat: Njirmegjesh nga Republika e Hungarisë, Altinova nga Republika e Turqisë, ndërsa kultivon dhe mban lidhjet dhe bashkëpunon edhe me shumë komuna të tjera, si me komunën e Rahovecit dhe Elez Hanit nga Republika e Kosovës, me Bursën nga Republika e Turqisë, ndërsa në proces e sipër është vëllazërimi edhe me qytetin turistik Burdur po ashtu nga Republika e Turqisë.

AKSES

Komuna e Studeniçanit me pozitën e saj në shtet, objektivisht gëzon një pozitë të favorshme gjeografike. Kjo komunë larg nga kryeqyteti është vetëm 12.1km. Komuna e Studeniçanit kufizohet me këto komuna, si në vijim: me komunën e Sopishtes, Kisella Vodës, Petrovecit, Zelenikovës, Çashkës dhe Makedonski Brodit. Rrjeti rrugor në komunë, përkatësisht lidhja e qendrës administrative (Studeniçan) me vendbanimet rurale, është në gjendje edhe më të keqe, sepse qendra komunale është e vendosur në fund të pjesës verilindore dhe i vetmi vend që lidhet drejtpërdrejt me të është fshati Moranë. Komunikimi me vendbanimet e tjera zhvillohet përmes rrugëve rajonale nga Shkupi drejt Draçevës dhe Nova Breznicës, përkatësisht drejt hidrocentralit "Kozjak", me të cilat janë të lidhura rrugët lokale komunale, të cilat shpeshherë janë në gjendje mjerueshme dhe shumë të keqe. Nga gjithsej 115km rrjet rrugor lokal, 67 km janë rrugë të asfaltuara, 20 km janë me makadam ose në sipërfaqe të thjeshtë toke, ndërsa 28 km janë të pashtruara. Rrjeti i rrugëve në vendbanimet rurale është në gjendje shumë të vështirë, ndërsa rrugë të asfaltuara pothuajse nuk ekziston.

VLERAT TURISTIKE

Vlerat turistike janë kushte të cilat mundësojnë që turizmi të shfaqet dhe të zhvillohet pa kurrfarë pengesash. Me atraktivitetin e tyre ato paraqesin motiv ose nevojë për turistët që ata t'i vizitojnë ato vende. Në esencë vlerat turistike ndahen në natyrore (të krijuara nga natyra) dhe antropogjene (të formuara nga njeriu).

Për nevojat e kësaj strategjie, është bërë vlerësimi i vlerave më domethënëse turistike natyrore dhe antropogjene në komunë.

VLERAT NATYRORE

Në kontekstin gjeologjik, territori i komunës së Studeniçanit është pjesë e zonës karstike më të njohur në vend, për sa i përket shkëmbinjve sipërfaqësorë dhe karbonike. Pjesa më e madhe (hapësirat më të larta) të komunës, sipas ndarjes gjeologjike janë pjesë e zonës së Pellagonisë (masivi i Pellagonisë, antiklinoriumi i Pellagonisë), i cili në veri zbret drejt zonës së Vardarit (fushëgropa e Shkupit) nga e cila është ndarë me struktura të deformuara. Në atë kuptim, zona përbëhet nga karbonate metamorfike të moshës prekambriane, kryesisht mermerë të thatë me kokrra mesatare me shtojcë nga dolomitet dhe kokrra dolomite të dobëta të bardha – gri.

Nga vlerat natyrore të komunës së Studeniçanit, në strategji janë përfshirë malet dhe hidrografia. Relievi në territorin e komunës së Studeniçanit është ndërtuar me forma lehtësuese karstike (kënetat, kanale, fusha karstike, shpella dhe gremina), të cilat gjatë epokës së akullnajave pësuan ndikime të forta akullnajore, mbetjet e të cilave janë të dukshme në relievin e sotëm. Dominojnë nga format e relievit të maleve të larta, të prera nga fushëgropat dhe luginat e lumenjve më të cekëta dhe më të thella, të cilat janë vendosur midis maleve Goleshnicë dhe Karaxhicë. Maja më e lartë në pjesën qendrore të Maqedonisë, Solunska Glava (Maja e Selanikut) (2.540m.), ndodhet në territorin e Komunës së Studeniçanit.

Në zonat e larta malore të Jakupicës formohen lumenjtë: lumi i Markut dhe lumi i Kadiut, të cilët në rrjedhat e sipërme të tyre rrjedhin nëpër komunë. Duke pasur parasysh se në territorin e komunës ndryshimi i lartësisë ndërmjet pikës më të ulët - e cila gjendet nën 400m., deri në majën më të lartë që është Maja e Selanikut (2.540m.), është më shumë se 2.000m. - për territorin e komunës së Studeniçanit do të jenë variacione karakteristike të konsiderueshme klimatike.

MALET

Mali i Mokrës ose vetëm Mokra, është masivi më i madh malor në Republikën e Maqedonisë së Veriut sipas shtrirjes së tij, i cili përbëhet nga malet Jakupicë, Karaxhicë, Dauticë, Goleshnicë dhe Kitkë. Maja më e lartë është Maja e Selanikut me lartësi prej 2.540 metrash. Përveç emrit Mokrë, ky mal i lartë shpeshherë përmendet vetëm si Jakupica, përkatësisht sipas degës së saj qendrore dhe më të lartë malore që paraqet edhe një nga degëzohen degët e tjera. Vargmali Mokra ndodhet në pjesën qendrore të Maqedonisë, i rrethuar nga luginat e lumenjve Vardar në lindje dhe Treska në perëndim. Në drejtim të jugut, masivi i malit Mokra hapet drejt Pellagonisë, përkatësisht drejt Fushës së Prilepit, ndërsa në veri drejt fushëgropës së Shkupit. Përbëhet nga më shumë pjesë malore, përkatësisht nga degët: Karaxhicë, Dauticë, Goleshnicë, Kitkë, Mumxhicë, mali i Sallakovës dhe Osoj. Masivi malor formohet në periudhën gjeologjike duke u copëtuar dhe deformuar. Bërthama është e përbërë nga karpate metamorfike të përbërë nga kokrra të mesme dhe më të mëdha e të ashpra, si dhe nga grimca të kristalta në të cilat gjenden shtresa të trasha gëlqere mezozoikësh dhe dolomitësh. Në mal ekzistojnë gjurmë të epokës së akullit, të përfaqësuara nga cirqe (dy liqene), koritë akujsh dhe tokë e fortë argjilore. Ky masiv malor është i pasur me ujë dhe

rrjet lumor të zhvilluar që përmes tij rrjedhin katër lumenj, si në vijim: lumi Babuna, Topolka, lumi i Kadiut dhe lumi i Markut - të gjitha janë degë të lumit Vardarit në zonën e pellgut Egje, ndërsa në malin Karaxhiicë ekzistojnë dy liqenet e njohura të Sallakovës. Masivi malor është jashtëzakonisht i pasur me pyje, kryesisht gjetherënës, si: ahu, lisi, asteni (*populus tremula*) dhe bredhi në pjesët e mesme dhe në ato më të ulëta, si dhe me drunj me gjelbërim të përhershëm si pisha, bredhi, omorika (*picea omorika*) në pjesët më të larta, ndërsa në pjesët më të ulëta ekzistojnë shkurre me kërcell të ulët, dru i egër etj. Në shpatet e masivit ekzistojnë edhe më shumë lloje të bimëve endemike, që janë karakteristike vetëm për këtë zonë, ndër të cilat është specia endemike e imët e pishës e quajtur *lakore* që gjendet në vetë majën e malit të Selanikut. Në pjesët më të larta mali Mokër është e pasur me kullota. Përveç majës më të lartë të Selanikut, majat tjera më të larta janë: Karaxhica (2.473m.), Kodra e Popit (2.380m.), Bregu i ashpër (2.365m.), maja Ubava (2.353m.), Maja e ashpër (2.275m.), Dautica (2.178m.) dhe Guri i Mirë (2.127m.). Nga bota e gjallë në vargmalet e Mokrës, jetojnë arinj, derra të egër, ujq, dhelpra, drerë nga kafshët e mëdha të egra, ndërsa veçanti janë edhe trungjet (lloj mongozë/herpestidae) të cilat jetojnë nëpër gropa e vrima të fushës së quajtur Fusha e Beut (Begovo Pole).

Karaxhaica. Një mal i lartë në Republikën e Maqedonisë së Veriut që përfshinë pjesën perëndimore të vargmaleve të Jakupicës dhe shtrihet në drejtimin juglindje-veriperëndim. Në drejtim të veriperëndimit vazhdon në Malin e Thatë (Suva Planina). Ana perëndimore e malit karakterizohet me çarje të pjerrëta dhe të larta malore që zbresin pothuajse vertikalisht në luginën e kanionit të Treskës. Majat më të larta janë: maja me të njëjtin emër, Karaxhicë (2.473m.), maja e Popit (2.380m.) dhe maja Ubava (2.350m.). Përbërja gjeologjike përfaqësohet nga gurët gëlqerorë për shkak të së cilave mali është plotësisht i karstifikuar pa rrjedha ujore sipërfaqësore, por me forma karstike sipërfaqësore, kryesisht më gropa dhe hendeqe të thella.

Goleshnica. Mal me lartësi mesatare në pjesën qendrore të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Në të vërtetë, Goleshnica i përket pjesës lindore të vargut të maleve Mokra Planina, por morfologjikisht është e ndarë prej tij. Ndodhet midis pjesëve të sipërme nga luginat e lumenjve të Kadiut dhe lumit Topolka, me shtrirje në drejtimin perëndim-lindje. Mali Goleshnica përfshin sipërfaqe prej 197km². Majat më të larta janë maja Lisec (1.935m.) dhe Sipiçan (1.789m). Në veri, përmes degës së tij Osmanbezhica (1.730m) dhe kreshtës Dërmos, bashkohet me Kitkën, ndërsa në perëndim, përmes Sipiçanit lidhet drejtpërdrejt me nyjën kryesore të tërë vargmaleve, përkatësisht me Fushën e Beut (Begovo Pole) dhe majat Përzhall dhe Maja e Selanikut (Sollunska Glava). Vetë emri (Goleshnica) na tregon se ky mal në të vërtetë është i varfër me pyje, d.m.th. se është i shpyllëzuar, gjë që kontribuoi në zhvillimin e erozionit intensiv të kohëve të fundit. Kjo gjendje është ndihmuar gjithashtu edhe nga shpatet e mëdha që janë karakteristike për shpatet veriore dhe jugore.

Kitka. Një mal i vendosur në juglindje të qytetit të Shkupit. Kitka është pjesë e masivit më të madh malor të Maqedonisë së Veriut, përkatësisht të malit Mokër dhe paraqet degën e verilindore. Mali Kitkë në perëndim lidhet me malin Karaxhicë, ndërsa në jug me malin Goleshnicë. Maja më e lartë gjithashtu është maja me të njëjtin emër: Kitkë, me lartësi mbidetare prej 1.588 metrash, ndërsa në kreshtë spikat maja Krastë me lartësi mbidetare prej 1.445 metrash, si dhe forma të njohura shkëmbore. Kreshta e malit Kitkë paraqet një pellg ujëmbledhës

të luginave të lumit të Markut dhe lumit të Kadiut. Zona e Kitkës në vete përmban një fond të pasur pyjor, kryesisht pemë gjetherënëse (ah, lis, aspen), si dhe drunjtë trung-shkurtër dhe shkurre halore, për shkak të të cilave prerja e egër e drunjtëve është shumë e përhapur, e cila në mënyrë të pamëshirshme e shkatërron pyllin. Në zonën e Kitkës ekzistojnë disa shtigje malore që janë pjesë e transfersales "Makedon" që shkon në drejtim të majës së Selanikut (Sollunska Gllava), ndërsa ekzistojnë edhe shtëpizat e restauruara malore "Kitka", si dhe vendbanimi turistik "Malla Reka". Në pjesën e saj veriperëndimore shtrihet zona e quajtur *Torbeshija*.



HIDROGRAFIA

Hidrografia në komunën e Studeniçanit përbëhet nga disa lumenj:

Lumi i Markut: Ky lum buron në kreshtën e vargmaleve Mokra (poshtë majës Pepeljak) dhe rrjedh drejt veriut duke fituar ujë nga dega e parë e majtë, humnera e lumit të Patishkës. Ky lum ka një gjatësi prej 30 km. dhe është një degë e djathtë e lumit Vardar. Deri te manastiri i Markut ky lum rrjedh në drejtimin veriperëndimor përgjatë asaj luginë, që është shumë e thellë dhe e ngushtë, por jo edhe ashtu me kthesa të mëdha; ndërsa te manastiri tashmë lumi çlirohet nga barrierat vertikale dhe zbret në rrëzë malit. Në luginën e lumit të Markut derdhen tre degët e tij më të vogla të djathta, si: lumi i Umovës, lumi i Cvetovës dhe përroi (lumi) Batinçica. Duke rrjedhur pranë fshatrave Varvara dhe Batincë, në afërsi të Draçevës, lumi i Markut hyn në fushëgropën e Shkupit dhe duke rrjedhur nëpër rrafshin aluvijal të saj në Fushën e Shkupit, pranë vendbanimit të Lisiçes së Epërme, derdhet në lumin Vardar. Origjina e emrit të lumit të Markut është e lidhur me sundimtarin mesjetar maqedonas Krale Marko që është një temë e zakonshme në folklorin maqedonas. Në fakt, sipas traditës popullore, Krale Marko me shpatën e tij kishte copëtuar shkëmbinj dhe male, kështu që e lëshoi edhe ujin të rrjedh. Sipas kësaj legjende, ujërat e Liqeneve të Sallakovës rrodhën përmes lumit të Kadiut në lumin Vardar në Veles, sepse shkëmbi i ngritur i pengoi ato që të rrjedhin në zonën e Shkupit. Meqë i nevojitej uji për ndërtimin e manastirit të

Markos, ai bëri një pengesë ku uji rrodhi në lumin e Kadiut, ndërsa një pjesë të ujit lejoi që të rrjedh në drejtim të kundërt në zonën e Shkupit. Në këtë mënyrë, Marku e rregulloi fillimin e rrjedhës së këtij lumi, kështu që edhe u quajt lumi i Markut.

Maksimumin e tij të ujit, lumi i Markut më shpesh më shpesh e arrin në pranverën e hershme, përkatësisht në periudhën kur bora në malin Karaxhicë dhe Mokër fillon të shkrihet, e kështu më pas niveli i ujit të lumit arrin prej 2 deri në 4 metra. Gjatë asaj periudhe të shpeshta janë edhe vërshimet dhe përmytjet që vijnë nga uji i tepërt, gjë që veçanërisht ndodh në fshatin Batincë, në afërsi të së cilit ekzistojnë shumë gjurmime rëre (baza betoni) të cilat shkaktojnë edhe ndryshimin e rrjedhës së lumit.

Lumi i Cvetovës: Ky lum rrjedh dhe kalon nëpër fshatin Cvetovë dhe derdhet në lumin e Markut, edhe atë pikërisht në anën e tij të djathtë menjëherë përballë manastirit të Markut. Ky lum mbulon një sipërfaqe ujëmbledhëse prej 33.1 km². Lumi i Cvetovës herë-herë është i pasur me ujë, dhe ashtu si të gjitha rrjedhat e tjera në pellgun e lumit të Markut, karakterizohet me ndryshime të mëdha të nivelit të ujit: që pas shkrirjes së borës dhe shirave të mëdha, paraqitet ujë i madh dhe i fuqishëm, ndërsa në verë ato pothuajse thahen.

Lumi i Patishkës: Ky lum gjendet në Malin e Thatë të Shkupit, në jug të Shkupit, i cili kalon nëpër fshatin me të njëjtin emër (Patishka Rekë) dhe derdhet në lumin e Markut. Ky lum mbulon një zonë ujëmbledhëse prej 197.4 km². Lumi buron duke mbledhur ujë nga kreshta Pepeljak në Karaxhicë, rrjedh nëpër fshatin Patishkë, prej ku - duke rrjedhur në drejtim të veriut dhe verilindjes - fundoset në lokalitetin Prisoj afër rrugës për në Dërzhilovë, ku më pas shfaqet si vazhdim i lumit të Thatës, duke u derdhur në lumin e Markut. Sipas të dhënave të revolucionarit maqedonas Gjorge Petrov në librin "Materiale pas studimit të Maqedonisë", lumi Patishkë fillon të rrjedhë në Majën e Zezë jo shumë larg Liqeneve të Sallakovës dhe zbret në luginën e thellë midis Karaxhiçës dhe Ibraimicës. Për dallim nga vazhdimi i saj i lumit të Thatë, lumi i Patishkës - edhe pse më i shkurtër - është më i plotë dhe rrjedh më fuqishëm, sepse kalon nëpër vende të pyllëzuara.



Lumi i Kadiut: Ky lum është degë e djathtë e lumit Vardar dhe është i gjatë 34 km. Zona e pellgut ujëmbledhës mbulon një sipërfaqe prej 184 km². Lartë në pjesën burimore,, ku takohen katër rrjedhat e lumenjve të harlisur, të shpejtë dhe të pastër, si: Juruçica, Aliagica, lumi i Sallakovës dhe vetë dalja nga burimi i lumit të Kadiut, ajo merr rrjedhën e saj kryesore që është tërësisht me një karakter të theksuar malor. Në rrjedhën e sipërme lumi i Kadiut rrjedh në drejtimin jug-veri, ndërsa nga fshati Alldincë deri në bashkimin me lumin Vardar. Lumi i Kadiut ka disa degë, por renditja e tyre është asimetrike, sepse numri i degëve që bashkëngjiten në anën e djathtë, janë më të shumtë, ndërsa nga ana e majtë bashkëngjitet vetëm një lum. Përgjatë rrjedhës së tij nga ana e djathtë, ky lum pranon ujë nga i ashtuquajtimi përroi i Peshterës dhe lumi i Dejkavecit. Në fshatin Dobrinë, në lumin e Kadiut,, përkatësisht në anën e tij të djathtë, bashkëngjitet dega më e madhe e quajtur Malla Reka. Dega e vetme e mbetur e lumit të Kadiut është lumi i Sallakovës. Duke rrjedhur nëpër një zonë shkëmbore dhe të ngushtë, ky lum derdhet në lumin Vardar në afërsi të fshatit Smesnicë. Përgjatë tërë rrjedhës (dhe veçanërisht në pjesën e sipërme) të lumit të Kadiut, mund të gjeni troftën e njohur e cila natyrshëm shumohet dhe jeton në këtë lumë. Për shkak të thellësisë së lumit të Kadiut që ajo e ka në rrjedhën e saj të poshtme, e që arrin prej 2 deri në 4 metra, lumi gjatë verës shpesh vizitohet nga notues dhe peshkatarë të ndryshëm. Ky lum është njëri nga lumenjtë më të pastër në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

VLERAT ANTROPOGJENIKE

Nga vlerat antropogjenë të komunës së Studeniçanit, në strategji janë përfshirë lokalitetet arkeologjike, objektet e kulturës, objektet fetare dhe manifestimet.

LOKALITETET ARKEOLOGJIKE

Isar: Vendbanim nga periudha e vonshme antike. Vendbanim i fortifikuar, mbetjet e të cilit shihen nga kufijtë e fshatrave Vërtekicë dhe Ramni Gaber.

Kalaja-gradishte: Opidum (vendbanim i fortifikuar) nga koha e vonë antike që gjendet në zonën e fshatit Alldincë, përkatësisht 2km në jug të shtëpizës malore "Karaxhicë" në një kodër me lartësi mbidetare prej 165 metrash, mbi vendtakimin e lumenjve Allagicë dhe lumi i Kadiut, në një rrafshnaltë me sipërfaqe prej 4 hektarësh, mund të shihen mbetjet e një muri të fortifikuar. Përgjatë sipërfaqes mund të vërehen enë të ndryshme qeramike, tuba për furnizimin me ujë, etj. Në veri të lokalitetit, përtej lumit, gjendet periferia në sipërfaqen e së cilës prej rreth 3 hektarësh, takojmë fragmente nga vazot prej qeramike, enë dhe pllaka çatie.

Muxhica: Vend i fortifikuar të periudhës së vonshme antike. Në 2.2km në juglindje të fshatit Alldincë dhe 1.7km në juglindje të shtëpizës malore "Karaxhiicë", në pikën më të lartë të kodrës përplot pyje, ekziston një sipërfaqe e rrafshët e cila është e rrethuar me një mur të ndërtuar me gurë, pa kurrfarë elementi ngjites, dimensionet e të cilit janë 60×220m. Në sipërfaqen e këtij objekti të mbetur antik, gjejmë enë nga qeramika, qypa dhe materiale të tjera ndërtimi.

Lokalitetet në afërsi të fshatit Osinçan; në një linjë ajrore drejt jugut nga qendra e qytetit të Shkupit rreth 13km, ku ekzistojnë mbetje specifike nga parahistoria, nga epoka e re e gurit, si dhe nga periudha antike, që dëshmon për

një kontinuitet të jetesës në këtë zonë. Fshati Osinçan konsiderohet si fshat shumë i vjetër, edhe atë si sipas traditave dhe legjendave popullore, ashtu edhe sipas mbetjeve antike, gjetjeve arkeologjike, si dhe sipas dokumenteve të shkruara. Tradita popullore thotë se fshati Osinçan ishte një fshat i madh maqedonas me rreth 300 shtëpi dhe tokë mjaft pjellore. Thuhet se ky fshat ishte i shpërndarë në disa lagje më të largëta në zonat e Brzovecit, Koçkovës, Crna Llomës, që në rast nevoje thirreshin nga ndonjëri nga një kodër, duke i rënë daulles. Për vjetërsinë e fshatit dëshmojnë edhe mbetjet e disa kishave të vogla të cilat fshatarët i konsideronin si kisha romake. Fshati përmendet në defterët e regjistrimit osman të viteve 1467/1468, edhe atë si pjesë e Vilajetit të Kosovës dhe kishte 42 familje të krishtera dhe 4 gra të veja të krishtera.

Në lokalitetin "Dabje", në zonën e fshatit Osinçan, është gjetur ndoshta një gur varri (1.20 x 0.60 x 0.10) në formën e një koke të stilizuar dreri me sy dhe hundë të theksuar, e cila sipas trajtimit të saj të përgjithshëm artistik jep të kuptojmë se ndërlidhet me motivet nga skulpturat e artit të Lepenski Virit.

Në majë e malit Cërna Lloma ose Ilina Gora, pak mbi fshatin Osinçan, janë ruajtur strukturat megalitike në formën e dolmenëve të cilat formojnë një vend të shenjtë, d.m.th. hapësirë origjinale e mbyllur e organizuar, e mbyllur në të tre anët me shkëmbinj dhe e mbuluar me një shkëmb masiv më të madh. Drejt këtij vendi të shenjtë shpie një "shteg" i shtruar me gurë të papërpunuar. Në afërsi të shenjtërores janë gjetur më shumë mbishkrime në shkëmbinj dhe gurë, të cilët tregojnë për një përfaqësim simbolik të yjësive "Akrepit", "Peshorja", "Dragoi", "Dashi", "Peshku", "Kryqi", etj., ndërsa në një shkëmb më të madh me dimensione 3.80 x 2.85 m. ekziston një rreth i gdhendur me një diametër 1.35 m. dhe një vrimë e zbrazët në mënyrë të çuditshme me sipërfaqe rreth 8 cm në sipërfaqen e rrethit, të cilat në fakt së bashku formojnë një SHENJË PLANETARE TË DIELLIT.

Në anën jugore të Crna Llomë ose Ilina Gorës, **në lokalitetin "Prisoj"**, janë regjistruar edhe dy vende të shenjta në formën e DOLMENIT, nga të cilat njëra me organizimin e saj hapësinor e simbolizon yjësinë "Shigjetari" dhe përmban elemente të kozmografisë së theksuar.

Kalaja e Markut (Markovo Kale): Kalaja feudale ndodhet 1 km në jugperëndim të manastirit të Markut. Ky lokalitet shfaqet rrëzë vargmalit Karaxhicë, që nga pjesa perëndimore e mbyll pjesën veriore nga gryka e gjatë e lumit të Markut. Nga ky vend kontrollohej rruga përgjatë lumit të Markut deri në burimin e saj, që përmes zonës malore të Karaxhicës vazhdon drejt zonave fqinje Poreçe dhe Azot. Sot kjo rrugë ka vetëm rëndësi lokale. Rrëzë pjesës veriore të Kalasë së Markut shtrihen liqenet antike të rërës së artë, të cilat herë pas here shfrytëzoheshin gjatë mesjetës dhe periudhës osmane, deri në kohën tonë.

OBJEKTE TË KULTURËS

Në fshatin Markova Sushicë akoma ekziston ndërtesa e vjetër me arkitekturë mjaft interesante të shkollës së dikurshme "Braça Milladinovci" dhe ndërtesa e bashkësisë lokale e cila është akoma në përdorim. Në fshatin Koliçani i Epërm ekziston Shtëpia Përkujtimore për asamblenë e çetave partizane të Shkupit.

OBJEKTE FETARE

Gjatë sundimit osman janë ndërtuar mjaft xhami, të cilat sot një numër tepër i madh i tyre pothuajse janë rinovuar ose tërësisht janë ndërtuar mbi themelet e xhamive të mëhershme. Ndër objektet fetare më të rëndësishme në Komunën e Studeniçanit mund t'i numërohen:

Xhamia - fshati Studeniçan.



Xhami- fshati Koliçan i Epërm.



Xhamia – fshati Vërtekicë



Xhamia – fshati Uji i kuq



Xhamia – fshati Alldinc



Xhamia – fshati Pagarush



Xhamia – fshati Gaber



Përveç xhamive në Komunën e Studeniçanit mund t'i hasim edhe disa objekte fetare të konfesionit ortodoks, ndër to mund të përmendim:

Kisha "Shën Nikolla Nikolimuki" në fshatin Markova Sushicë, e cila daton nga shek. XII. Kjo kishë është e vendosur në fund të fshatit, përkatësisht në jugperëndim të fshatit, vetëm 300 metra larg manastirit të Markut. Më saktë, kisha gjendet në anën e majtë të rrugës që shpie drejt manastirit të Markut në afërsi të tij, 300 metra para manastirit. Përballë kishës në anën tjetër të rrugës ekziston një çezmë e quajtur Çezmeja e Tonievit, e po ashtu ekzistojnë edhe varreza.

Kisha "Shën Atanasi" në fshatin Osinçan.

Kisha "Shën Nikolla" në fshatin Osinçan. Kjo kishë ndodhet në hyrje të fshatit, përkatësisht në anën e djathtë të rrugës. Kisha e Shën Nikollës është një kishë e krishterë ortodokse maqedonase në fshatin Osinçan. Sipas asaj që besonin fshatarët, kjo kishë ishte "romake", si dhe varret përreth saj, ku u gjetën edhe "monedha romake".

Manastiri i Markut: Manastiri "Shën Dhimitri" është quajtur edhe "Manastiri i Markut". Ky manastir ndodhet në jug të fshatit Markova Sushicë, në luginën e lumit të Markut, përkatësisht në bregun e tij të majtë, dhe 20 km. larg Shkupit. Menjëherë në anën e djathtë fillon konaku i manastirit dhe dhomat e tjera ndihmëse. Pranë konaqeve ekziston edhe një furrë, kazanë për zierjen e verës, një pus me ujë të ftohtë dhe një mulli shumë i vjetër i cili është ruajtur si kujtim i kohës kur gruri bluhej në një mënyrë të tillë. Kompleksin e manastirit e përbëjnë: Kisha mirë e ruajtur e manastirit të Shën Dhimitrit nga shek. XIV dhe hajati i

hapur nga shek. XIX, kambana e madhe, oborri i rregulluar i manastirit me gjelbërim dhe me një pishinë të vogël, dy dhoma për të ngrënë, në muret e të cilave figurojnë freska të shek. XIV, një kuzhinë ku prodhohet bukë karakteristike nga tharmi dhe bukë integrale, konaqe me veranda të bukura që mund të strehojnë 40 vizitorë, një paraklis (kishë e vogël kushtuar Shën Apostullit Mark), një muze manastiri, një galeri ikonash, një dyqan për shitjen e suvenireve, një mulli që gjendet në oborrin e manastirit, tualet për meshkuj dhe tualet për femra, etj. Manastiri akoma është aktiv, ndërsa në të ekziston murgjëri femrash.



MANIFESTIME

Në periudha të ndryshme kohore gjatë vitit në territorin e komunës së Studeniçanit organizohen dhe mbahen më shumë manifestime. Nga ngjarjet dhe manifestimet kulturore në komunën e Studeniçanit rëndësi më të madhe zë mundja, përkatësisht luftimet e pehlivanëve dhe turneu ndërkombëtar i pehlivanëve, që tradicionalisht mbahet në këtë komunë.



Mundja apo pehlivanllëku në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe konkretisht në territorin e komunës së Studeniçanit, ka një traditë të gjatë dhe është planifikuar që të mbrohet si trashëgimi kulturor. Manifestimi ndërkombëtar kulturor dhe sportiv - mundja "Tradita vazhdon" në Studeniçan, Shkup, organizohet për çdo vit. Në këtë manifestim marrin pjesë mundës-pehlivanë nga disa vende të Ballkanit, si nga: Turqia, Greqia, Bullgaria, Kosova, Shqipëria dhe mundës nga vendi që garojnë në disa kategori. Përveç mundësve, në këtë manifestim marrin pjesë edhe shoqëri kulturore dhe artistike që interpretojnë dhe këndojnë këngë dhe valle të vjetra, ndërsa vendasit e Studeniçanit përgatisin ushqime tradicionale për mysafirët, si p.sh. gjomleze, tatli me krunde, sutlijaç dhe specialitete të tjera që janë karakteristike për rajonin.



Funksioni kulturor i mundjes si një sport tradicional në komunën e Studeniçanit, paraqet një lloj artefakti kulturor për shkak se posedon më shumë elemente me prapavijën kulturore në strukturën e saj të brendshme. Përmes këtij sporti kultivohet një trajtim të veçantë në raport me trupin, përkatësisht një regjim i veçantë në të ushqyer, ushtrime të përditshme mundimplote të cilat kontribuojnë në shëndet më të mirë të pjesëmarrësve në këto lojëra. Vet akti i mundjes në vetvete përmban një sërë rregullash që e rregullojnë mënyrën e sjelljes së pjesëmarrësve në këtë sport tradicional, ndërsa për luftën pjesëmarrësit e lyejnë trupin e tyre me vaj. Nga ana tjetër, edhe dita kur mbahet ky manifestim nënkupton një lloj spektakli me shumë spektatorë, por edhe mundës nga të gjitha anët e vendit, si dhe nga jashtë.

SEKTORI I SHËRBIMEVE

Sektori i shërbimeve përfshin objektet e ushqimit dhe pijeve, akomodimin, agjencitë e udhëtimit, kantinat për ruajtjen e verës, bankat, zyrat postare, fabrikat, entet shëndetësore, farmacitë, pikat e karburantit, foto-studiot, tregjet dhe objektet sportive.

HOTELIERIA

Objektet hotelierike që ofrojnë shërbime për t'u ushqyer dhe argëtim në komunën e Studeniçanit janë këto në vijim: restoranti "Bela" - Batincë, "Etno Selo",

Manastiri i Markut - Markova Sushicë, kafe - restoranti "Erensa" - Markova Sushicë, restoranti "Fortis" - Studeniçan, furra "Totaj" - Batincë, restoranti "Guri 1" - Studeniçan, basen për peshq - restorant në Majën e Zezë, restoranti "Metin Doner" - Studeniçan, restoranti "Buja" - Studeniçan, restoranti "Te Ibraimi" - Studeniçan, etj.

AKOMODIM

Në komunën e Studeniçanit ekzistojnë objektet e mëposhtme të akomodimit, si në vijim: hoteli "Villa Princ" - Alldincë, shtëpiza malore "Karaxhiica", etj.



AGJENCITË TURISTIKE

Në territorin e komunës së Studeniçanit veprojnë disa kompani të transportit, si në vijim: "Amsa Trans" - Studeniçan, "Euro Boss Raf" - Studeniçan, "Seko Trans-Kom" - Batincë, "Euro Company" - Batincië.

FABRIKA

Fabrika për prodhimin e këpucëve Samuraj – Studeniçan;

Fabrika për prodhimin dhe përpunimin e plastikës dhe produkteve plastike "Burdem Plastik" – Studeniçan;

Ferma e pulave "6 Vëllezërit"- Batincë.

BANKA

Në komunën e Studeniçanit funksionojnë disa bankomatë: Halk Bank - Studeniçan.

POSTA

Në territorin e komunës së Studeniçanit njësia e Postave të Maqedonisë kryen të gjitha aktivitetet në lidhje me dërgimin e dërgesave dhe shërbimeve postare sipas pagesës së faturave nga qytetarët.

ENTE SHËNDETËSORE

Për banorët e komunës që kanë nevojë për trajtim dhe kujdes shëndetësor, kujdesi shëndetësor sigurohet përmes organizatave shëndetësore private – ordinanca të përgjithshme dhe të specializuara, si dhe ordinanca dentare: "Avicena" - Batincë, "Emergjenca" - Studeniçan, "Melem" - Studeniçan, "M-Dent" - Studeniçan, "Intra Vitam Medicus" - Batincë, "Benita Dent" - Studeniçan, "Mekiç Dent" - Batincë, "Refleks Medika" - Studeniçan, etj.

FARMACI

Në territorin e komunës së Studeniçanit ekzistojnë një varg barnatoresh, si në vijim: "Cidonia" - Studeniçan, "Tina Farm" - Batincë, "Gold Mun 4" - Moranë, "Sara Farm" - Studeniçan.

PIKA KARBURANTI

Në territorin e komunës së Studeniçanit ekzistojnë këto pika karburanti: "Kuvajt Petrol" - Studeniçan, "Beroviç" - Batincë.

TREGJE

Në territorin e komunës ekzistojnë disa shitore të mëdha për shitjen e mallrave dhe prodhimeve, si dhe një treg. Marketet në komunën e Studeniçanit janë: "Bati-Alfa" - Batincë, "Muzo Market" - Batincë, "Zulu market" - Studeniçan dhe "Super 2000 Sami DOOEL" - Studeniçan.

SPORT

Në komunën e Studeniçanit ekzistojnë disa klube dhe shoqata të regjistruara sportive, si në vijim: Klubi i Karatesë "Dan Kyu-Xhiu Xhica" - Studeniçan, klubi i mundjes "Studeniçan" - Studeniçan dhe klubi i futbollit "Studeniçan" - Studeniçan.

REKREACION

Pamjet e shkëlqyera panoramike, peizazhet piktoreske të maleve përreth, burimet e shumta dhe pyjet e dendura në zonat malore të komunës së Studeniçanit, formojnë kushte të shkëlqyera për aktivitete rekreative në natyrë. E gjithë kjo është plotësuar me ajër të pastër dhe të freskët që garanton kënaqësi të vërtetë. Shpatet e maleve janë të pasura me bimë gjetherënëse dhe me kërcell të ulët dhe me shkurre, duke ofruar mundësinë për shëtitje rekreative dhe aktivitete të tjera. Malet përreth janë të pasura me lloje të ndryshme të frutave pyjore, edhe atë kërpudha, çaje, luleshtrydhe të egra, boronicë, manaferra, mjedra, etj., si dhe kërpudha, barishte dhe shumë bimë të tjera. Aktivitetet e gjuetisë dhe të

peshkimit, gjithashtu kanë potencial të madh për zhvillim në komunën e Studeniçanit, kryesisht për shkak të sasisë të shumtë në lumin e Kadiut.

LLOJE TË TURIZMIT

Në këtë pjesë janë përshkruar llojet e ndryshme të turizmit që kanë mundësinë të zhvillohen edhe në komunën e Studeniçanit, ku dhe nga të cilët do të zhvilloheshin. Këto janë si më poshtë:

- Turizmi kulturor dhe historik;
- Turizmi gastronomik;
- Turizmi shëndetësor;
- Aktivitete në natyrë dhe turizëm sportiv;
- Turizmi i gjuetisë dhe peshkimit.

Turizmi kulturor - historik përfshin udhëtimet turistike të motivuara nga interesat kulturore që përfshijnë vizita në vendet dhe monumentet historike, muze dhe galeri, festivale, zanate tradicionale dhe mënyra të jetesës në bashkësi. Në këtë lloj të turizmit bëjnë pjesë edhe turizmi rural, eko-turizmi, turizmi fetar, etj. Në territorin e komunës së Studeniçanit ekziston mundësia për zhvillimin e këtij lloji të turizmit, edhe atë për shkak të trashëgimisë kulturore dhe historike që paraqet një dëshmi për vendin e rëndësishëm të cilin komuna e gëzonte gjatë gjithë historisë. Komuna e Studeniçanit posedon potencial të madh për zhvillimin e turizmit rural, si dhe të eko-turizmit, edhe atë për shkak të natyrës së pastër dhe të paprekur dhe klimës së këndshme.

Turizmi gastronomik përfshin një gamë të gjerë aktiviteteve në lidhje me ushqimin, edhe atë nga oferta e kuzhinës specifike dhe tradicionale, e deri te organizimi i garave gastronomike dhe manifestimeve që ndërliken me ushqimin. Përfshirja e ushqimeve të caktuara në ofertën e objekteve hotelierike, iniciativat si: java e një ushqimi të caktuar dhe ofertë nga ana e pronarëve të objekteve hotelierike në komunë në intervale të caktuara kohore me çmime të caktuara, përfshirjen e turistëve në vëzhgimin ose përgatitjen e ushqimeve dhe trajnimit, etj. Si një rajon me histori dhe traditë të pasur kulturore, rajoni i Kratovës është mjaft tërheqës dhe ushqyes që patjetër që çdo turist duhet të provojë para se të largohet.

Turizmi shëndetësor përfshin udhëtimet me qëllim të shërimit ku motivi kryesor i pacientëve gjithmonë ka qenë shërbimi shëndetësor me cilësi më të mirë. Në dekadën e fundit, përveç kërkimit të një shërbimi më të mirë, kërkimi për një shërbim më të lirë është bërë një forcë lëvizëse, gjë që e bën udhëtimin për shërim edhe më masiv. Organizatat për turizëm e njohin mundësinë e zhvillimit të kësaj dege të re në turizëm dhe fillon zhvillimi i kompanive të cilat specializohen në organizimin e shërbimeve të tilla si akomodimi, transporti, përkthimi, përcjellja, vizitat për pacientët dhe të shoqëruesve të tyre. Me këtë, merren parasysh nevojat e veçanta të pacientëve për të cilët ndonjëherë nevojitet një lloj i veçantë i transportit ose akomodimit. Natyra e paprekur në komunë mundëson shëtitje, pamje të bukura, qëndrim në ajër të pastër për turistët, etj.


Aktivitetet në natyrë dhe turizmi sportiv përfshijnë një diapazon të gjerë aktiviteteve që vizitorët dhe turistët mund t'a realizojnë. Nga njëra anë bëhet fjalë për mundësitë rekreative në natyrë, siç është ecja në këmbë, vështrimi i bukurive natyrore, piknikët, manifestimet, etj. Në anën tjetër përfshin lloje të ndryshme të

sporteve dhe garave. Turizmi sportiv parqet udhëtim nga arsyet jo komerciale për të marrë pjesë ose për të ndjekur aktivitete sportive jashtë vendbanimit të përhershëm; shprehja e sjelljes së njerëzve gjatë kohës së tyre të lirë - kohë për pushim - që pjesërisht shfrytëzohet në mjedisin natyror dhe pjesën tjetër në objekte për sport dhe rekreacion; pushim që përmban aktivitete sportive ose si pjesëmarrës ose si spektator. Relievi i pasur dhe i larmishëm i komunës së Studeniçanit, ofron mundësi ideale për zhvillimin e këtij lloji të turizmit duke i rregulluar shtigjet për turizëm aktiv.

Turizmi i gjuetisë dhe peshkimit përfshin një spektër të gjerë të aktiviteteve që ndërlidhen me gjuetinë dhe peshkimin, si dhe me pajisjet dhe infrastrukturën e nevojshme për t'i realizuar këto aktivitete. Malet e pasuria me florën dhe faunën, si dhe rezervat e mëdha të peshqve nëpër lumenjtë e kësaj zone, ofrojnë kushte të shkëlqyera për zhvillimin e turizmit të gjuetisë dhe peshkimit. Por, sigurisht se duhet të punohet edhe në ndërtimin e infrastrukturës rrugore dhe turistike për të paraqitur ofertë të plotë turistike.

PLANI I VEPRIMIT, OBJEKTIVI STRATEGJIK, PRIORITETET DHE MASAT

Plani i veprimit në strategji është hartuar në përputhje me Qëllimin themelor, i cili buron nga vizioni dhe misioni i strategjisë. Plani i veprimit i përmban të gjitha njohuritë e rëndësishme që rrodhën nga hulumtimet, si dhe nga punëtoria e mbajtur dhe puna me fokus të grupeve. Qëllimi kryesor i strategjisë për zhvillimin e turizmit në komunën e Studeniçanit, është formimi i kushteve për rritje të zhvillimit të turizmit. Ky qëllim do të realizohet përmes tre përparësive themelore që i kanë masat e tyre të veprimit. Masat janë përshkruar përmes parametrave në vijim: aktivitete, bartësit, afati kohor dhe treguesit e suksesit.



Tre prioritetet themelore që kanë të bëjnë me zhvillimin e turizmit në komunën e Studeniçanit, janë këto në vijim:

Prioriteti 1 - Forcimi i kapaciteteve dhe partneriteteve në funksion të shfrytëzimit të trashëgimisë natyrore dhe kulturore me qëllim të zhvillimit të turizmit;

Prioriteti 2 - Përmirësimi i infrastrukturës turistike;

Prioriteti 3 - Hartimi i një oferte të njohur turistike.

Në tekstin në vijim, në formë të tabelës, janë paraqitur masat, aktivitetet, bartësit (të interesuarit), afati kohor dhe indikatorët për sukses për secilën përparësi veçmas.

PROPOZIM I AKTIVITETEVE PROJEKTUESE

Prioriteti 1: Forcimi i kapaciteteve dhe partneriteteve në funksion të shfrytëzimit të trashëgimisë natyrore dhe kulturore me qëllim të zhvillimit të turizmit.

Masa: 1.1. Organi për menaxhim të destinacionit

Bartës	Afati kohor
Komuna e Studeniçanit, sektori publik, grupi i biznesit, organizatat joqeveritare, palët e interesuara për zhvillimin e turizmit	2021

Aktivitetet	Indikatorët për sukses
1. Themelimi i një organi për menaxhimin e destinacionit në komunën e Studeniçanit	1. Numri i vizitorëve dhe turistëve
2. Oferta e unifikuar sipas njësive tematike	2. Numri i produkteve dhe shërbimeve të integruara
3. Hartimi i brendit për destinacion - komuna e Studeniçanit, sloganit i destinacionit	3. Brend të përgatitur dhe slogan për destinacionin
4. Përgatitja e një sistemi online të integruar të menaxhimit me destinacionin	4. Organi i themeluar për menaxhment të destinacionit
5. Rritja e kuantitetit (sasisë) dhe kualitetit (cilësisë) së ofertës turistike	5. Mundësia online për t'a rishikuar ofertën e destinacionit
6. Formimi i një organi për menaxhimin me krizat në destinacion	6. Organi i themeluar për menaxhim me krizat në destinacion.

Masa: 1.2. Iniciativë për unifikimin e entiteteve turistike dhe hotelierike në nivel komunal

Bartës	Afati kohor
Komuna e Studeniçanit, sektori publik, grupi i biznesit, organizatat joqeveritare, palët e interesuara për zhvillimin e turizmit	2021

Aktivitetet	Indikatorët për sukses
1. Njohje me iniciativën e të gjithë faktorëve relevantë në komunën e Studeniçanit në fushën e turizmit dhe hotelierisë	1. Informim i të gjithë faktorëve relevantë të turizmit dhe hotelierisë
2. Organizimi i një takimi për tu njohur me vizionin, misionin dhe qëllimet e shoqatës	2. Numri i pjesëmarrësve në takim
3. Asistencë këshilluese për formimin dhe fillimin me punë të shoqatës	3. Numri i pjesëmarrësve në shoqatë.

Masa: 1.3. Trajnimi i punëtorëve lokalë të turizmit dhe hotelierisë në Komunën e Studeniçanit

Bartës	Afati kohor
Komuna e Studeniçanit, Fakultetet për turizëm	2020-2024

Aktivitetet	Indikatorët për sukses
1. Organizimi i trajnimeve dhe regjistrimi i kandidatëve	1. Punëtorë të trajnuar të hotelierisë turistike
2. Intervistë me kandidatët dhe realizimi i trajnimit	2. Ngritja e cilësisë së turizmit
3. Dorëzimi i një raporti dhe unifikim (regjistri i vetëm) të punëtorëve të rinj lokalë të turizmit	3. Rritja e numrit të turistëve
	4. Përgatitje të vendeve të reja të punës
	5. Qasje deri te informacionet për potencialet turistike të komunës
	6. Numri i orëve të mbajtura, numri i pjesëmarrësve dhe certifikatat

Masa: 1.4. Inkurajimi i aktiviteteve investuese në turizëm

Bartës	Afati kohor
Komuna e Studeniçanit, sektori publik, grupi i biznesit, organizatat joqeveritare, palët e interesuara për zhvillimin e turizmit	2020-2024

Aktivitetet	Indikatorët për sukses
1. Përdorimi i fondeve IPA - programet për bashkëpunim ndërkufitar	1. Shuma e fondeve të shfrytëzuara nga programet
2. Shfrytëzimi i fondeve nga IPARD programet	2. Numri i projekteve të aplikuara dhe të fituara
3. Shfrytëzimi i lehtësive të përfshira në zonat e zhvillimit turistik	3. Trajnime të organizuara për aplikimin e thirrjeve
4. Organizimi i trajnimeve për aplikimin e thirrjeve	

Masa: 1.5. Forcimi i kapaciteteve të komunës - forumi për turizëm

Bartës	Afati kohor
Komuna e Studeniçanit dhe të gjithë palët e interesuara për turizëm	2021

Aktivitetet	Indikatorët për sukses
1. Themelimi i një forumi për turizëm të komunës i cili do ta monitorojë procesin e zhvillimit të turizmit në komunë dhe do të japë propozime për zhvillimin e mëtejshëm të turizmit në komunë (Takimet: tremujore, pjesëmarrësit: të gjithë palët e interesuara).	1. Forumi i themeluar për turizmin në komunë

Masa: 1.6. Partneritete dhe bashkëpunim me komunat nga vendi dhe jashtë saj

Bartës	Afati kohor
Komuna e Studeniçanit	2021-2024

Aktivitetet	Indikatorët për sukses
1. Nënshkrimi i memorandumeve të bashkëpunimit me komuna nga vendi dhe jashtë saj	1. Numri i memorandumeve të nënshkruara për bashkëpunim
2. Përgatitje të projekteve të përbashkëta për mbështetjen dhe promovimin e turizmit në komuna	2. Numri i projekteve të përbashkëta për mbështetjen dhe promovimin e turizmit nëpër komuna
3. Përforcimi i departamenteve për bashkëpunim ndërkombëtar në komunë përmes trajnimeve dhe vizitave studimore	3. Trajnime dhe vizita studimore

Masa: 1.7. Organizim të një kalendari të ngjarjeve për tërë vitin në komunën e Studeniçanit

Bartës	Afati kohor
Komuna e Studeniçanit, sektori publik, grupi i biznesit, institucionet arsimore	2021-2024

Aktivitetet	Indikatorët për sukses
1. Formimi i një këshilli të organizatorëve të cilët do të ofrojnë min. 4 max. 8 ngjarje (manifestime): deri në 2 me temë kultura, arkitektura, historia, dy për turizmin aktiv, deri në dy tema për eko-turizmin ose turizmin rural dhe deri në dy për specialitetet gastronomike dhe ato lokale.	1. Këshilli i formuar i organizatorëve
2. Programi i manifestimeve	2. Manifestimet e realizuara

Masa: 1.8. Zhvillimi i praktikës dhe volonterizmit

Bartës	Afati kohor
Komuna e Studeniçanit, sektori publik, grupi i biznesit, organizatat joqeveritare, popullata vendase	2021-2024

Aktivitetet	Indikatorët për sukses
1. Hartimi i një baze për entitetet e interesuara për pranim të praktikantëve dhe të vullnetarëve	1. Numri i entiteteve të përfshira
2. Hartimi i një baze të praktikantëve dhe vullnetarëve të mundshëm	2. Numri i kandidatëve të paraqitur
3. Përgatitja e një programi afatshkurtër dhe afatmesëm për praktikë dhe vullnetarizmin	3. Numri i kandidatëve të trajnuar
4. Trajnime për promovim dhe prezantim në praktikë dhe vullnetarizëm	4. Numri i vullnetarëve dhe praktikantëve të përfshirë

Prioriteti 2: - Përmirësimi i infrastrukturës turistike

Masa: 2.1. Qendër turistike të informacionit dhe shitore të suvenireve

Bartës	Afati kohor
Komuna e Studeniçanit, grupi i biznesit	2021

Aktivitetet	Indikatorët për sukses
1. Programi për punën e qendrës së informacionit	1. Numri i vendeve të reja të punës
2. Person i angazhuar në qendrën e informacionit	2. Numri i kontratave të lidhura dhe të suvenireve e shitura
3. Koordinimi me të gjithë faktorët përkatës nga turizmi dhe hotelieria	3. Numri i vizitorëve
4. Kontratat e nënshkruara për prodhimin e punëve të dorës me popullatën lokale	4. Qendër e hapur për informacione dhe shitore të suvenireve

Masa: 2.2. Rregullimi i lokaliteteve potenciale për zhvillimin e turizmit

Bartës	Afati kohor
Komuna e Studeniçanit	2021-2024

Aktivitetet	Indikatorët për sukses
1. Përgatitja e dokumentacionit të planifikimit hapësinor	1. Dokumentacioni i përgatitur hapësinor – planifikues
2. Realizimi i furnizimit publik	2. Procesi i kryer i furnizimit publik
3. Kryerja e detyrave	3. Numri i tavolinave të vendosura, koshave të mbeturinave, tabelave të informacionit dhe tabelave me kodeks etik

Masa: 2.3. Shënimi i lokaliteteve të rëndësishme turistike

Bartës	Afati kohor
Komuna e Studeniçanit	2021

Aktivitetet	Indikatorët për sukses
1. Paraqitja në hartë të atraksioneve dhe vendndodhjeve turistike në territorin e Komunës së Studeniçanit	1. Plaka të informimit të vendosura sipas lokaliteteve të rëndësishme turistike
2. Realizimi i konkursit publik për hartuesit e tabelave të informimit	2. Numri i tabelave të vendosura të informacionit
3. Vendosja e tabelave të informacionit	3. Numri i lokaliteteve të shënuara
	4. Numri i zejtarëve të angazhuar vendas

Masa: 2.4. Ndërtimi i lokacioneve për hapësirën e parkimit të autobusëve turistikë, vendosja e tualeteve publike

Bartës	Afati kohor
Komuna e Studeniçanit	2021-2023

Aktivitetet	Indikatorët për sukses
1. Përzgjedhja e lokacioneve për ndërtimin e hapësirës së parkimit të autobusëve turistikë dhe vendosja e tyre	1. Lokacione të zgjedhura dhe hapësira parkimi të ndërtuara për autobusët turistikë
2. Përzgjedhja e lokacioneve për instalimin e tualeteve publike dhe vendosja e tyre	2. Lokacione të zgjedhura dhe vendosja e tualeteve publike
(Rekomandohet të jenë afër njëri-tjetrit, si dhe në afërsi të qendrës së informacionit turistik)	3. Numri i turistëve të cilët e përdorin hapësirën e parkimit për autobusët turistikë

Masa: 2.5. Restaurim dhe revitalizim të ndërtesave të vjetra për qëllime turistike në muze etno-historik

Bartës	Afati kohor
Komuna e Studeniçanit, grupi i biznesit, palët e interesuara për zhvillimin e turizmit	2021-2024

Aktivitetet	Indikatorët për sukses
1. Paraqitja në hartë të objekteve të vjetra	1. Paraqitja në hartë të objekteve të vjetra
2. Përgatitja e një plani dhe dokumentacioni për revitalizimin e tyre dhe vënia në funksion të mundësive turistike në komunën e Studeniçanit	2. Përgatitja e planit dhe dokumentacionit për restaurim dhe revitalizim
3. Ofertë për investitorët, OJQ-të, institucione ndërkombëtare ose partneritet publik-privat	3. Rritja e numrit të vizitorëve

Masa: 2.6. Rregullimi dhe shënimi i shtigjeve për këmbësorë dhe për biçikleta

Bartës	Afati kohor
Komuna e Studeniçanit, grupi i biznesit, palët e interesuara për zhvillimin e turizmit	2021-2024

Aktivitetet	Indikatorët për sukses
1. Shënimi i shtigjeve për këmbësorë dhe biçikleta në territorin e Komunës së Studeniçanit	1. Shënimi i shtigjeve për këmbësorë dhe biçikleta
2. Realizimi i konkursit publik për hartuesit e tabelave të informacionit	2. Realizimi i konkursit publik për hartuesit e tabelave të informacionit
3. Vendosja e tabelave të informacionit	3. Vendosja e tabelave të informacionit

Masa: 2.7. Përmirësimi i qasjes në objektet turistike-hotelierike

Bartës	Afati kohor
Komuna e Studeniçanit, grupi i biznesit, palët e interesuara për zhvillimin e turizmit	2020-2024

Aktivitetet	Indikatorët për sukses
1. Përmirësimi i aksesit në objektet turistike dhe hotelierike që synojnë turistët e mundshëm, përfshirë këtu edhe personat me aftësi të kufizuara, të moshuarit dhe personat me nevoja ose kërkesa të veçanta	1. Përmirësimi i aksesit në objektet turistike dhe hotelierike
2. Rregullimi i bazës materialo-teknike të objekteve	2. Rregullimi i bazës materialo-teknike të objekteve
3. Ndarje të mirënjohjeve pronarëve të objekteve me "akes" më praktik	3. Ndarje të mirënjohjeve pronarëve të objekteve me "akes" më praktik
	4. Numri i turistëve

Prioriteti 3: Hartimi i një oferte të njohur turistike

MMasa 3.1. Organizimi i ngjarjeve dhe manifestimeve

Bartës	Afati kohor
Komuna e Studeniçanit, sektori publik, grupi i biznesit, organizatat joqeveritare, palët e interesuara për zhvillimin e turizmit, institucionet ndërkombëtare, institucionet arsimore, Agjencia për përkrahjen e promovimit të turizmit, Ministria e Ekonomisë - Sektori për turizëm dhe hotelieri	2021

Aktivitetet	Indikatorët për sukses
1. Publikimi i një programi të ngjarjeve në fillim të çdo viti	1. Programi i publikuar i ngjarjeve
2. Ftesa e ekspertëve të shquar në fushën e turizmit për çdo manifestim veçmas (përqendrimi sipas llojit të ngjarjes)	2. Ekspertë të ftuar të cilët janë të shquar në fushën e turizmit
3. Organizimi i tribunave (turizmi rural, ekoturizmi, turizmi aktiv, etj.) dhe përcjellja e tendencave dhe trendëve të reja në turizëm	3. Organizimi i tribunave
	4. Numri i pjesëmarrësve
	5. Konkludime nga tribunat

Masa: 3.2. Aranzhmane turistike për vizitë të komunës

Bartës	Afati kohor
Grupi i biznesit, agjencitë turistike, sektori publik, palët e interesuara për zhvillimin e turizmit	2021-2022

Aktivitetet	Indikatorët për sukses
1. Përgatitja e llojeve të ndryshme të aranzhimeve turistike për ta vizituar komunën (si oferta të ndara dhe si pjesë integrale e turneve në qarkullim)	1. Janë përgatitur lloje të ndryshme të aranzhimeve turistike për ta vizituar komunën (turne një ditore, turne treditore, vikend vizita në Studeniçan, turne avanturiste, adrenaliste dhe aktive, etj.)

Masa: 3.3. Zhvillimi i llojeve të turizmit

Bartës	Afati kohor
Grupi i biznesit, organizatat joqeveritare, palët e interesuara për zhvillimin e turizmit	2021-2022

Aktivitetet	Indikatorët për sukses
1. Përgatitje të ofertës të përbashkët për lloje të ndryshme të turizmit në komunën e Studeniçanit (Aktiv, Argëtues, Sportiv)	1. Ofertë e përgatitur për lloje të ndryshme të turizmit

Masa: 3.4. Përgatitje të ofertës gastronomike në objektet hotelierike

Bartës	Afati kohor
Grupi i biznesit, palët e interesuara për zhvillimin e turizmit, institucionet e larta arsimore, organizatat joqeveritare	2021-2022

Aktivitetet	Indikatorët për sukses
1. Pasurimi i ofertës së specialiteteve gastronomike në objektet hotelierike	1. Pasurimi i ofertës gastronomike
2. Përgatitje të menyve në mënyrë speciale të dizajnuara	2. Meny të përgatitura
3. Promovimi i kuzhinës nacionale	3. Është promovuar kuzhina nacionale dhe specialitetet tradicionale
	4. Numri i klientëve dhe komentet për ushqimin

Masa: 3.5. Promovimi në internet, rrjetet sociale

Bartës	Afati kohor
Komuna e Studeniçanit, sektori publik, grupi i biznesit, organizatat joqeveritare, palët e interesuara për zhvillimin e turizmit, Info qendra	2021-2022

Aktivitetet	Indikatorët për sukses
1. Hartimi i një ueb faqe në internet për promovimin turistik të komunës	1. Është hartuar një ueb faqe në internet për promovim turistik
2. Forcimi i promovimit të komunës përmes rrjeteve sociale	2. Numri i komenteve, monitorimi dhe shikimi në rrjetet sociale
	3. Rritje të numrit të vizitorëve

Masa: 3.6. Përgatitje të materialit promovues për komunën, suvenirë dhe ciceronë

Bartës	Afati kohor
Komuna e Studeniçanit, sektori publik, grupi i biznesit, organizatat joqeveritare, zejtarët, institucionet arsimore, palët e interesuara për zhvillimin e turizmit, personalitete të njohura nga komuna	2021-2022

Aktivitetet	Indikatorët për sukses
1. Përgatitja e materialit promovues për komunën, broshura dhe video	1. Është përgatitur material promovues
2. Përgatitja e suvenireve që janë karakteristike për komunën	2. Janë përgatitur suvenire
3. Përgatitja e udhëzuesve turistik në tërë komunën	3. Suveniret e shitura
	4. Numri i zmadhuar i vizitorëve
	5. Është përgatitur udhëzues turistik për komunën dhe është rritur promovimi

Masa: 3.7. Promovimi i komunës nëpër panaire për turizëm


Bartës	Afati kohor
Komuna e Studeniçanit, Agjencia për përkrahjen dhe promovim të turizmit, grupi i biznesit, palët e interesuara për zhvillimin e turizmit	2021-2024

Aktivitetet	Indikatorët për sukses
1. Prezantimi dhe promovimi i komunës përmes një oferte të përbashkët nëpër panaire turistike kombëtare dhe ndërkombëtare	1. Promovimi i komunës në panairet kombëtare dhe ndërkombëtare të turizmit
2. Përzgjedhja e panaireve ku do të prezantohet komuna	2. Partneritete të lidhura dhe takime të realizuara
	3. Promovimi i potencialeve turistike të komunës
	4. Rritje të numrit të vizitorëve

PROCESI IMPLEMENTIMIT TË STRATEGJISË

Për monitorimin dhe realizimin e suksesshëm të dokumentit strategjik, përkatësisht të procesit të implementimit të strategjisë, nevojitet një model për monitorimin, vlerësimin dhe implementimin e strategjisë për zhvillimin e turizmit në komunën e Studeniçanit. Modeli është i rëndësishëm për përdorimin përfundimtar të strategjisë nga pikëpamja teorike në atë praktike. Bazuar në këtë model, strategjia e ardhshme mund të plotësohet në pjesët ku kjo strategji nuk është realizuar, të ofrohen shpjegime dhe udhëzime në mënyrë që të vazhdohet zhvillimi i turizmit në komunë në mënyrë të vazhdueshme.

Diagrami 2. Procesi i implementimit të Strategjisë për zhvillimin e turizmit në komunën e Studeniçanit.



Në bazën e modelit është formimi i një Komisioni për vlerësimin e strategjisë që kryen monitorimin, vlerësimin dhe zbatimin e strategjisë. Në këtë Komision duhet të inkuadrohen anëtarë nga të gjithë palët e interesuara, komuna, grupi i biznesit, udhëheqësit e projekteve, agjencitë donatore, institucionet arsimore, organizatat joqeveritare, etj. Komisioni ka për detyrë të organizojë takime periodike me palët e interesuara, të përgatisë raporte vjetore mbi strategjinë me rekomandime, si dhe të organizojë konferencë vjetore për palët e interesuara ku do të paraqiten rekomandimet.

LITERATURA

- United Nation World Tourism Organization (2019) International Tourism Highlights, 2019 Edition. Madrid: United Nation World Tourism Organization.
- Димитров, Н., Ташков, Н., Методијески, Д. (2015) Водич низ регионите на Македонија. Скопје: АППТРМ.
- Димче, К. (1996) Археолошка карта на Република Македонија. Скопје: МАНУ.
- Државен завод за статистика (2016) Попис на капацитетите во угостителството во Република Македонија. Скопје: Државен завод за статистика.
- Државен завод за статистика (2019) Регионите во Република Северна Македонија. Скопје: Државен завод за статистика.
- Кол & Партнер (2016) Национална стратегија за развој на туризмот на Република Македонија 2016-2020. Скопје: Министерство за економија.
- Општина Студеничани (2015) Стратегија за климатски промени на општина Студеничани (2015-2025). Студеничани: Општина Студеничани.
- Општина Студеничани (2019) Интегриран план за локален развој на општина Студеничани (2019-2023). Студеничани: Општина Студеничани.
- Петровска, С., Целески, А. (2014) Стратегија за туризам, со акционен план на град Скопје, за периодот 2014-2018 година. Скопје: Град Скопје.
- Центар за развој на Скопскиот плански регион (2015) Програма за развој на Скопскиот плански регион 2015-2019. Скопје: Центар за развој на Скопскиот плански регион.

